Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 12 (184) DHJETOR 2021. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

BIG market

AKTUALITET

Albchrome ikën nga Bulqiza, padrejtësitë mbeten aty

Nga **bulqizaime.al** — Faqe 3

REPORTAZH

Një shkollë me emrin e Heroit të Paqes Klodian Tanushi

Nga **HALIL RAMA** — Faqe 11

HISTORI

Dibra pas Pavarësisë Kombëtare (1912-1918)

Nga **KRISTO FRASHWRI** — Faqe 10

HOMAZH

Iljaz Kaca - mësuesi, studiuesi, arkeologu dhe qytetari i palodhur

Nga **SELMAN MËZIU / HYSEN UKA** — Faqe 15

Zhvillohet në Akademinë e Shkencave konferenca shkencore **"100 vjet nga lufta e Dibrës"**

Lufta e Vlorës dhe lufta e Dibrës bënë realitet Pavarësinë e shpallur

Vlora, Dibra, Kopliku dhe Korça i kthyen sovranitetin dhe territorialitetin e humbur shtetit shqiptar

Gjinushi: **Është koha** *që në vend të historisë folklorike* **të kemi historinë e librave**

"Vetëdija kombëtare e dibranëve dha dëshminë më të rëndësishme të saj gjatë asaj dekade jo vetëm në luftën vetëmbrojtëse, por edhe me pjesëmarrjen e vullnetarëve të saj në luftën e Vlorës dhe në mënyrë të veçantë me pjesëmarrjen e organizuar në mbrojtje të Shkodrës e në rezistencën popullore të Lumës ndaj së njëjtës ushtri pushtuese"
"Kjo ishte Dibra e Dom Nikollë Kaçorrit dhe Vehbi Dibrës, të cilët Ismail Qemali i zgjodhi njërin nënkryetar të qeverisë dhe tjetrin kryemyfti të meshihatit mysliman shqiptar... Kjo ishte Dibra e Jashar Erebarës dhe Isuf Xhelilit; e Osman Pacit - Selam Musait dibran; kjo ishte Dibra e atyre që lanë malet e bajraqet dhe u bashkuan nën flamurin e të parëve."

— LEXONI NË FAQET 2,4,5



Foto: Neki Feta

INTERVISTË ME SHKRIMTARIN AGRON TUFA

"Ngjizja e papërlyeme" është një sagë rrëqethëse e shoqërisë shqiptare në fillim të viteve '60

Romani, tetralogjia "Ngjizja e papëlyeme", është ndërtuar në bazë rrathësh interferues rrëfimorë, gjithsej katër, me një prolog dhe epilog të zhvendosur në kohën e sotme që legjitimon instancën nga ku shkarkohet rrëfimi dhe një intermexo, "Orë pa akrepa", që na jep idenë e palëvizshmërisë, pezullimit të rrjedhjes së Kohës. Rrathët rrëfimorë janë romane që kanë në epiqendër një protagonist, i/e cili (cila) ose rrëfen në vetë të parë, ose na jepet në veprim përmes vetës së tretë.

— LEXONI NË FAQET 6-7



NË BRENDËSI:

■ **Mustafa Tola**: "Kjo konferencë për luftën 9-vjeçare është nder dhe vlerësim i veçantë për Dibrën" ■ **Abdurahim Ashiku**: Është koha për një memorial që i bën nder Dibrës mbarë ■ **Bulqiza, "bukuroshja e fjetur"** ■ **Petrit Ndreu** i Dardhës që nga Amerika i thotë "Jo Skavicës!" ■ **Sofra** e kullës së madhe në Lashkizë ■ **Fabula** nga Mevlud Buci ■ **Pesha e gruas** - tregim nga Osman Xhili ■ **Duriç**, arti yt të bëri të pavdekshëm!

POSTA SHQIPTARE

Pajtohu në gazetën **RRUGA E ARBËRIT** pranë çdo filiali të **POSTËS SHQIPTARE në të gjithë Shqipërinë.** Një pajtim vjetor kushton **600 lekë.**

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 12 (189). Dhjetor 2021
Gazeta doli nga shtypi, 29 dhjetor 2021.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit janar 2022.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra
Editor i faqes online: Agim Deva
Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Adem BUNGURI
Vesel HOXHA
Arif MATA
Ferzileta XHIKA
Shaqir ÇERPJA
Arjeta ÇUKA
Halil RAMA
Selman MËZIU
Besnik RAMA
ISMEN BRIKA
HAJRI SHEHU

Redaksia falenderon përzemërsisht zotin **Xhavit Hysa** për donacionin prej 5000 lekësh dhënë për gazetën.

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Zhvillohet në Akademinë e Shkencave konferenca shkencore "100 vjet nga lufta e Dibrës"

Lufta e Vlorës dhe lufta e Dibrës bënë realitet Pavarësinë e shpallur

Vlora, Dibra, Kopliku dhe Korça i kthyen sovranitetin dhe territorialitetin e humbur shtetit shqiptar

Trajtohet për herë të parë në nivel akademik lufta heroike 9-vjeçare kundër pushtuesve serbë


Foto: Neki Feta

***

Për herë të parë historia e luftës heroike 9-vjeçare të Dibrës kundër pushtuesve serbë bëhet objekt kërkimor në nivel akademik.

Më 20 dhjetor Akademia e Shkencave, në bashkëpunim me Institutin e Studimeve të Historisë Ushtarake dhe shoqatën "Çidhna dhe Kastriotët" organizuan konferencën shkencore "100 vjet nga lufta e Dibrës".

Akademik Skënder Gjinushi përshëndeti të pranishmit dhe përgëzoi institucionet bashkëpunuese për organizimin e konferencës shkencore "100 vjet nga Lufta e Dibrës". Ai tha se kjo konferencë zhvillohet në vijim të veprimtarive të tjera për ngjarje jubilare që lidhen me dekadën e parë të shtetit shqiptar pas shpalljes së Pavarësisë.

"Kemi përkujtuar e nderuar 100-vjetorin e themelimit të shtetit, 100-vjetorin e krahinës autonome të Korçës, 100-vjetorin e Kongresit të Lushnjes, 100-vjetorin e Luftës Kombëtare të Vlorës dhe sot jemi për të vlerësuar e nderuar 100-vjetorin e Luftës së Dibrës.

Kjo është dekada gjatë së cilës ndodhi procesi historik i kalimit nga shpallja e Pavarësisë tek njohja dhe rikonfirmimi i saj. Dhe në këtë kontekst Lufta e Vlorës dhe Lufta e Dibrës kanë qenë ngjarje që e bënë pavarësinë të vërtetë, sepse i kthyen shtetit shqiptar sovranitetin në gjithë territorin e tij, penguan copëtimin e vendit dhe vendimet e padrejta për rishikimin e kufijve të Shqipërisë caktuar më 1913.

Ashtu siç Lidhja Shqiptare e Prizrenit përgatiti Shpalljen e Pavarësisë, ashtu Lufta e Vlorës dhe ajo e Dibrës vulosën vetë pavarësinë.

Lufta e Dibrës qe një luftë popullore, që shfaqi të njëjtat ndjenja e veprime atdhetare si dibranët që kishte në krah themeluesi i shtetit shqiptar Ismail Qemali: dom Nikollë Kaçorri e Vehbi Dibra. Figura të tilla si Elez Isufi e Isuf Xhelili, Ismail Strazimiri, Jashar Erebara, Osman Paci, janë të përmasave kombëtare dhe meritojnë nderimin tonë.

Lufta e Dibrës dëshmoi se historikisht Shqipërinë e kanë dashur "të madhe" vetëm nëse do të ishte nën sundim dhe pavarësinë e saj kanë qenë të detyruar ta njohin vetëm kur dikush tjetër ka tentuar të shtrijë fuqinë e vet ushtarake dhe regjimin e pushtimit", - tha akademik Gjinushi.

Më pas përshëndeti z. Mustafa Tola, kryetar nderi i shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët", i cili falënderoi Akademinë e Shkencave për konferencën që përkujton këtë ngjarje me rëndësi jo vetëm për historinë e Dibrës, por për gjithë shqiptarët.

Sipas një programi me larmi tematike, në 19 referate e trajtesa u evidentuan ngjarjet, prijësit, heronjtë dhe aspekte organizative e taktiko-luftarake të kësaj lufte legjendare.

Referuan akademikët Pëllumb Xhufi, Shaban Sinani, Beqir Meta e Marenglen Verli; profesorët e studiuesit e njohur Paskal Milo, Adem Bunguri dhe Bajram Xhafa; si dhe Bernard Zotaj, Zaho Golemi, Moisi Kamberi, Asllan Zemani, Dritan Murrja e Sali Kadria.

Kontribute paraqitën edhe historianët e studiuesit dibranë Xhafer Martini, Ali Hoxha, Mustafa Tola, Zabit Lleshi, Kadri Dauti, Haki Përnezha etj.

Akad. Pëllumb Xhufi e vlerësoi Luftën e Dibrës si një nga hallkat kryesore të lëvizjes për pavarësimin e Shqipërisë në përgjigje të kundërveprimeve për ndarjen dhe përcaktimin e kufijve nga Fuqitë e Mëdha, ndërkohë që Serbia po zgjeronte planet e saj për pushtimin e trojeve shqiptare.

Prof. dr. Paskal Milo foli për aspektin diplomatik të rezistencës dhe luftës së dibranëve kundër ndërhyrjes dhe pushtimit jugosllav (1918-1921) dhe e konsideroi këtë moment historik si rizgjimin kombëtar, ndërkohë që forcat serbe mbanin në vitin 1918 të pushtuar krahinat verilindore si dhe ato të Dibrës së Poshtme. Prof. Milo tha se ndërkohë që Serbia po ngrinte administratat e saj në trevën e Dibrës, kjo luftë frenoi vendosjen e regjimit jugosllav në Shqipëri. Lufta e Dibrës 100 vite më parë ishte akti i fundit i përpjekjeve për sigurimin e unitetit territorial të shtetit shqiptar. Ishte vijimi dhe pëmbysja e një procesi historik kombëtar që nisi me Kongresin e Lushnjës, vazhdoi me luftën e Vlorës e përfundoi e luftën e Dibrës

Akad. Beqir Meta foli për situatën e ndërkombëtare kur u zhvillua Lufta e Dibrës, ku vlerësoi fillimin e ndryshimeve pozitive në politikën britanike, që u shpreh edhe me mbështetjen e Shqipërisë për pranimin e saj në Lidhjen e Kombeve.

Rreth figurës së Elez Isufit foli akad. Shaban Sinani në kumtesën "Lufta e Dibrës sipas Ismail Strazimirit". Duke iu referuar librit me kujtime të Strazimirit, sipas tij, një protagonist parësor në Dibër e në gjithë Shqipërinë dhe dëshmuesi më i besueshëm i saj, akad. Shabani tha se Shqipëria e kujtimeve të Ismail Strazimirit është një republikë tribale, një shtet etnografik. Midis argumenteve themelorë ku shfaqet dëshmia historike e tij janë: përhapja e esadizmit nëpër Shqipëri; konflikti i anadollakëve me europeistët për qeverisjen e saj; vizitat e Esad pashës në Dibër dhe kthimi i tij nga Serbia po përmes Dibrës; vetëshpallja e Ahmet Zogut kryetar i Matit dhe Dibrës; grindjet e fabrikuara të tij për shenjat e flamurit kombëtar; lufta e Shkodrës, lufta e Kolesianit; shpallja e republikës së Mirditës; lufta e popullit të Dibrës për rikthimin në kufijtë e përcaktuar më 1913; ngutja e Hasan Prishtinës për të filluar një veprim luftues ndaj Serbisë para se ushtritë austrohungareze të zbrisnin më në jug të saj; gabimet e disa atdhetarëve me emër në viset veriore të Shqipërisë; lëvizja dibrane e marsit të vitit 1922 dhe rrethimi i qeverisë në Tiranë; qendresa e shtëpisë së Ndreut dhe vdekja e Elez Isufit prej plagëve. Mbi të gjitha ky është një libër për Elez Isufin, këtë hero popullor që bënte luftën dhe e fitonte dhe pastaj kthehej në kullë të tij. Ai jep shpjegimet më të vërteta dhe më bindëse për çdo veprim të Elez Isufit.

Prof. asoc. dr. Moisi Kamberi foli më gjerë për rëndësinë e Kuvendit të Arrasit dhe betejën e Lanë-Lurës, duke i quajtur si kulmin e zhvilimit të ngjarjeve shqiptare zhvilluar në Shkodër-Dibër-Vlorë dhe si një pikë kthese në zhvillimet shqiptaro-jugosllave. Ai tha se kryengritja e gushtit e 1920-së Lan Lurës shënoi dukuri e strategji të shkëlqyera të udhëheqësve popullorë e të forcave vullnetare dibrane kundër një armiku të pabarabartë të pajisur mirë me armatim e municion.

Kadri Dauti foli për Luftën e Sërpetovës, si hallkë e rëndësishme e zinxhirit të luftërave dibrane kundër serbëve, e qëndresës atdhetare dibrane, me ndikim të madh në vendimin e Konferencës së Ambasadorëve, më 9 nëntor 1921, e cila hodhi poshtë pretendimet jugosllave për "vijën strategjike" në perëndim të Dibrës. Me këtë luftë, populli dibran copëtoi propagandën dhe përpjekjet e bandës së Esad Toptanit për të manipuluar opinionin dibran dhe atë shqiptar, se Serbia ka ardhur në Shqipëri si vëlla.

Haki Përnezha foli për luftën e Çidhnës në vitet 1912-1921, ku shovinistë serbë, pasi pësuan humbjen më 22 shtator 1913 filluan hakmarrjen duke vrarë, prerë e shkatërruar gjithçka.

Akad. Marenglen Verli, në kumtesën e tij "Qëndresa kundër pushtuesve serbë në vitet 1912-1913" u përqendrua në argumentimin e shkaqeve që i detyruan shqiptarët e Dibrës e më gjerë që të organizojën një qëndresë shumëformëshe kundër pushtuesve serbë deri tek kundërshtimi me armë që arriti kulmin në kryengritjen e 1913-s.

Ai tha se politika e terrorit të shpërnguljes që ushtruan në ekstrem qarqet drejtuese të Beogradit nëpërmjet instrumentave të tyre të dhunës në Dibër dhe në trevat e tjera shqiptare, nuk u la alternativë tjetër shqiptarëve, pëveçse të rezistojnë me të gjitha mjetet e rezistencës. Ata nuk mund të pajtoheshin me alternativën e nënshtrimit dhe asimilimit. Me këtë kryengritje që zuri fill me luftën ballkanike në tetorin e vitit 1912 dhe vazhdoi për vite të tëra duke i kushtuar një humbje të jashtëzakonshme demografike popullsisë së trevës së Dibrës, dibranët e vijuan qëndresën edhe më pas edhe pas vitit 1920, kur u krijua

Grupi Balfin shet kompaninë "Albchrome Holding SHPK" te shoqëria "Yildirim International Mining Investments B.V". SMBB u bën thirrje të gjithë minatorëve që të bashkohen dhe të kërkojnë të drejtat që na janë mohuar prej kohësh. "Së bashku mund të fitojmë edhe një kontratë kolektive dinjitoze."

Reagim i Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës:

Albchrome ikën nga Bulqiza

shfrytëzimi, padrejtësitë dhe vdekjet e minatorëve që la pas

Albchrome është larguar zyrtarisht nga miniera më e madhe në Bulqizë. Aksionet e saj janë shitur te kompania turke Yildirim International Mining Investments B.V. Albchrome po ikën, por mbeten shfrytëzimi, padrejtësitë dhe vdekjet e minatorëve gjatë administrimit të saj.

Në Bulqizë kompania Albchrome do të mbahet mend më së shumti për katër gjëra:

1. FAVORIZIMIN FLAGRANT NGA SHTETI

Albchrome erdhi në Bulqizë 9 vite më parë, gjatë qeverisjes së Sali Berishës, duke blerë nga kompania Albanian Chrome të gjitha aksionet e koncesionit 30-vjeçar të minierës. Opozita e kohës, e drejtuar nga Edi Rama, pati kritika të shumta duke e quajtur si favorizim për pronarin e Albchrome, oligarkun Samir Mane. Por me ardhjen në pushtet Edi Rama e zgjati edhe me 10 vjet të tjera koncesionin, edhe pse nuk ishin përmbushur investimet e parashikuara në kontratë.

Shteti financoi Samir Manen për hapjen e Tranverbankut të Klosit, me justifikimin e rivënies në punë të Fabrikës së Pasurimit në Klos. Por kjo e fundit nuk u vu kurrë në punë. Paratë e dhëna nga shteti u përdorën për të ulur kostot e pronarit për nxjerrjen e ujit nga miniera dhe ndërtimin e ndonjë HEC-i me këtë ujë. Financime nga shteti janë marrë edhe për fabrikat e Ferrokromit në Burrel dhe Elbasan.

Vit pas viti Albchrome ka pasur favorizime sa i përket uljes apo heqjes së taksave dhe rentës minerare. Sidomos viteve të fundit, edhe me justifikimin të pandemisë, renta minerare është hequr fare. Kjo nuk është shoqëruar aspak me përmirësim të pagave apo kushteve të minatorëve, përkundrazi ka ndodhur në një kohë kur Albchrome ka shtypur barbarisht organizime sindikale nga vetë punëtorët.

2. VDEKJET DHE AKSIDENTET NË PUNË

Gjatë nëntë viteve të shfrytëzimit të minierës nga Albchrome, kanë vdekur nëntë minatorë, rasti i fundit ishte në muajin maj të këtij viti. Familjarëve të disave prej këtyre punëtorëve nuk iu është dhënë as dëmshpërblimi i jetës, ose janë sorollatur dyerve të gjykatave. Madje kompania paturpërsisht ende e mohon vdekjen e këtyre punëtorëve, edhe pse janë raste publike.

Aksidentet kanë qenë të panumërta, por Albchrome-i ka përdorur çdo mjet që të mos bëhen publike. Në shumicën e rasteve punëtorëve nuk iu është dhënë as dëmshpërblimi për aksidentin e ndodhur, duke ua lënë si përgjegjësi vetë punëtorëve. Tre-katër vitet e fundit Albchrome-i refuzonte edhe pranimin e raporteve shëndetësore.

Prej të paktën dy vitesh, sipas raporteve të Inspektoratit të Punës, Albchrome-i është kompania me numrin më të madh të aksidenteve në punë. Kjo ka ardhur si pasojë e rritjes së normave të punës dhe shfrytëzimit pa kriter të minierës.

3. SHFRYTËZIMI BARBAR I REZERVAVE TË KROMIT

Me hapjen e pusit të thellësisë nisi dhe shfrytëzimi barbar i rezervave të kromit në minierën e Bulqizës. Makineri të shfrytëzimit masiv u futën në të gjitha nivelet aktive të minierës, duke rritur ndjeshëm nxjerrjen e kromit dhe shkurtuar jetëgjatësinë e minierës.



Minatorë dhe anëtarë të Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës duke protestuar para hyrjes së minierës së kromit në Bulqizë që administrohet nga kompania Albchrome. Foto: Sami Curri/BIRN.

Rritja e shfrytëzimit të rezervave të kromit u shoqërua me intensifikimin e shfrytëzimit të minatorëve, të cilëve iu rriten vazhdimisht normat, por jo pagesa. Pagat që marrin minatorët në kompaninë Albchrome nuk kanë ndonjë dallim të madh prej pagave të marra në vitin 2013. Pa përmendur këtu faktin që nuk paguhet vjetërsia në punë, vështirësia etj., në një kohë që rreziqet për jetën janë të jashtëzakonshme, veçanërisht nga prania e gazit metan në minierë.

4. LUFTA E ASHPËR NDAJ SINDIKALIZMIT

Megjithë këtë situatë, organizimi dhe ngritja e zërit prej minatorëve nuk ka munguar në këta vite. Por përgjigjet prej kompanisë Albchrome dhe shtetit në krah të saj kanë qenë të ashpra dhe të paligjshme.

Në vitin 2017 punëtorët u organizuan spontanisht për të kërkuar të drejta duke zhvilluar një protestë para kompanisë. Për këtë u pushuan nga puna minatorët Ferat Kurti dhe Bajram Duka, ndërsa dhjetëra të tjerë u paralajmëruan me pushim nga puna. Sindikata kukull e Kol Nikollës dhe Taf Kolecit ishte përkrah kompanisë, kundër punëtorëve.

Në vitin 2019, pas një organizimi spontan që kërkonte më shumë të drejta, u themelua nga vetë minatorët Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës. Vetëm pesë ditë pas shpalljes në qendër të Bulqizës, Albchrome-i pushoi nga puna kryetarin Elton Debreshi. Më vonë edhe tre anëtarë të Këshillit Sindikal: Beqir Buriçin, Behar Gjimin dhe Ali Gjetën.

Grevës disaditore të minatorëve iu kundërvu kompania, institucionet shtetërore në shërbim të saj, sindikatat e korruptuara të Kol Nikollës dhe Gëzim Kalasë. Vijoi një proces i gjatë falsifikimesh dokumentacioni prej aktorëve të lartpërmendur, kërcënime e presione të paskrupullta ndaj punëtorëve, vetëm e vetëm për të mos lejuar organizimin e tyre të pavarur. Mediat heshtën turpshëm prej parave të oligarkut Samir Mane.

Sot, pas nëntë vitesh, pronari i Albchrome-it Samir Mane është disafish më i pasur, ndërkohë që lë pas minatorë të keqpaguar, të gjymtuar dhe të kërcënuar, burime minerare të keqshfrytëzuara dhe një gërmadhë sociale në Bulqizë. Fitimet e tij marramendëse nga kromi i Bulqizës investohen jashtë Shqipërisë. Ndërkohë pronarët e rinj turq duket se do të vazhdojnë të njëjtën rrugë me pararendësin e tyre, duke bërë pakt me kolegun e servilëve e të korruptuarve Kol Nikolla e Taf Koleci, famëkeqin Gëzim Kalaja dhe pseudosindikatën e tij.

SMBB u bën thirrje të gjithë minatorëve që të bashkohen dhe të kërkojnë të drejtat që na janë mohuar prej kohësh. Së bashku mund të fitojmë edhe një kontratë kolektive dinjitoze.

www.bulqizaime.al

Kronologjia e kompanive që kanë administruar Minierën e Bulqizës

Grupi Balfin që është koncensionari më i madh në zonën krom mbajtëse të Bulqizës nëpërmjet kompanisë Albchrome Holding, ka vendosur përfundimisht të largohet nga sektori minerar në Shqipëri.

Në njoftimin e shpërndarë për mediat nga Autoriteti i Konkurrencës bëhet me dije se palët kanë depozituar dokumentet shoqëruese në lidhje me transaksionin midis "Balkan Finance Investment Group", lidhur me përftimin e kontrollit të shoqërisë Albchrome Holding SHPK dhe filialeve të saj nga shoqëria Yildirim International Mining Investments B.V. Vlera e transaksionit nuk bëhet e ditur nga palët. "Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros." Thuhet në njoftimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Shoqëria Yildirim International Mining Investments B.V. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Hollandë, pjesë e grupit turk Yildirim, grup që operon në një numër të madh industrish si metalurgji dhe miniera, energjetikë, prodhimin e plehrave kimike, fertilizuesve dhe kimikateve, menaxhimin e porteve, ndërtim, transport, logjistikë, etj. Grupi në fjalë është një biznes në pronësi të familjes turke Yildirim. Sipas informacionit zyrtar në faqen e grupit, thuhet se zhvillon biznes në 51 shtete të botës dhe ka rreth 13 mijë të punësuar.

Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës e konsideroi këtë ndryshim kompanishë në Minierën e Bulqizës si jo të rëndëishëm për punëtorët dhe që asnjëherë nuk janë pyetur për problemet që ka sektori. "Kompania AlbChrome e Samir Manes po iken nga Bulqiza. Mori shume nga ajo miniere: mori kromin e bulqizakeve dhe te gjithe shqiptareve, por me e keqja eshte se mori edhe 9 jete minatoresh. Per keta deshmore nentoke askush nuk u precedua penalisht, por faji ngeli tek viktimat. Edhe familjet e tyre qe sot po vuajne per buken e gojes." thuhet në deklaratën e SMBB-së.

Albchrome Holding në bilancet e dorëzuara për dy vitet e fundit, raportoi një ecuri jo të mirë financiare. Në tetor 2019, të pakënaqur me përfaqësimin sindikal dhe kushtet e punës, një grup punëtorësh të minierës, të mbështetur nga aktivistë të majtë të Organizatës Politike, themeluan Sindikatën e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, SMBB. Tre ditë pasi u njoftua publikisht themelimi i sindikatës, Albchrome shkarkoi nga puna me pretendimin e shkeljeve disiplinore kreun e saj, Elton Debreshi. Në javët në vijim, kompania shkarkoi edhe tre minatorë të tjerë – anëtarë të Këshillit Sindikal të SMBB-së, ndërsa kjo e fundit u angazhua në një protestë disa ditore para hyrjes në minierë, për të kundërshtuar shkarkimet.

Tradicionalisht minatorët e kësaj miniere janë përfaqësuar në marrëdhëniet e tyre me punëdhënësin nga FSPISH – e udhëhequr nga Taf Koleci, e cila ka mbajtur në përgjithësi marrëdhënie të afërta me pronarin e minierës.

Kompania Albchrome që zotëron edhe pjesën më të madhe të zonës krom-mbajtëse të Bulqizës, prej kur është privatizuar ka kalur si pronësi në disa kompani. Në vitin 2001 ishte kompania italiane "Darfo" që kishte fituar të drejtën koncesionare për shfrytëzimin e pjesës më të madhe të rezervave të kromit dhe prodhimin e ferrokromit në Shqipëri për 30 vjet, përfshirë minierën e Bulqizës dhe fabrikën e pasurimit në Burrel, si dhe fabrikën e ferrokromit në Elbasan.

Në vitin 2007-të Albanian Chrome në atë kohë pjesë e grupit austriak "Deco Metal" hyri në tregun shqiptar, pasi bleu të drejtat koncesionare të kompanisë italiane "Darfo". Këta të fundit u larguan në vitin 2013-të, pas një sërë protestash nga sindikatat e kohës për pagat dhe kushtet e punës. Në janar të vitit 2013-të Balfin sh.p.k bleu 100% të aksioneve. Në korrik të vitit 2016-të, Kuvendi zgjati edhe me 10 vjet të tjera afatin e koncensionit të Minierës së Kromit në Bulqizë, për kompaninë private ACR Holding si pjesë e Balfin Group. Nga qeveria e Partisë Socialiste kjo zgjatje e periudhës së koncesionit deri në vitin 2040, u arsyetua lidhur me investimet shtesë që do të kryente koncesionari në Bulqizë.

Për më shumë lajme rreth shitjes së minierës së Bulqizës shih
www.bulqizaime.al

Rruga e Arbërit nr. 184

konferencë



Lufta e Vlorës dhe lufta e Dibrës bënë realitet Pavarësinë e shpallur

mbretëria kroato- slloveve (jugosllave) dhe qëndruan gjithnjë pjesë e rëndësishme e lëvizjes shqiptare për çlirimin e bashkimin kombëtar.

Prof. dr. Bajram Xhafa mbajti temën " Pse zgjati 9 vjet lufta e Dibrës?".

"Krajlat e Ballkanit dhe të përtej Ballkanit deshën ta shkyenin copash Shqipërinë e shkatërruar plotësisht në Luftërat Ballkanike 1912-1913, të mbytur në gjak e të pambrojtur nga askush", theksoi Xhafa në referimin e tij.

"Luftërat dhe pas-luftërat ballkanike qenë një genocid e pastrim etnik nga koalicioni i krishterë ortodoks ballkanik mbi shqiptarët. Shkaku i gjakderdhjes nëntë vjeçare të shqiptarëve ishte anatema e Evropës ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve, e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës më 1912-1913. Principata Shqiptare e Konf. së Londrës sipas diplomatit amerikan Ëiliams, qe vetëm një sundim tiranik dhe një despotizëm i deklaruar me urgjencë; mesa gjykohet, kjo qe një anarki për të shkaktuar revolucione. E tillë mbeti ajo edhe më pas dhe vazhdon edhe sot. Luftat dhe revolucionet u bënë kodi i fatit dhe jetës së shqiptarëve. Historia e Luftës së Dibrës (1918-1921) dhe fati i saj është shëmbëlltyra tipike e tragjizmit shqiptar. Këngët heroike të trimave të luftës, dibranët dhe gjithë shqiptarët duhet t'i shndërrojnë në këngë vaji", theksoi prof. dr. Bajram Xhafa.

Prof. dr. Adem Bunguri mbajti referimin me temë "Barbarizmat serbe në Dibër në vitet 1913-1921". "Vështirë të gjendet në Europë, një rast tjetër i ngjashëm, i krahasueshëm me urrejtjen patologjike të serbo-sllavëve ndaj shqiptarëve, i ardhacakëve ndaj autoktonëve" - theksoi në fillim të referimit të tij prof. Adem Bunguri.

"Sipas burimeve historike bizantine, serbët lidhen me valën e fundit të invazionit skllaven në gad. Ballkanik, rreth viteve 630-640 pas Kr., pra në periudhën e fundit të sundimit të perandorit Herakli. Kronikat paleobizantine janë të mbushura me krime të shumta të turmave skllavene e atyre barbare mbi ilirët autoktonë. Që atëhere e deri më sot, mund të thuhet se serbët kanë qenë dhe janë në armiqësi të hapët me ilirët dhe më vonë me shqiptarët autokton", tha mes të tjerash prof. Bunguri.

Prof. asoc. dr. Zaho Golemi foli për udhëheqësit e kryengritësve në Luftën e Dibrës dhe theksoi se kjo kryengritje nisi kur qeveria e Beogradit vazhdonte t'i mbante forcat në kufijtë strategjikë me Shqipërinë dhe filloi të ndërtonte fortifikime e posta doganore.

Kumtesa e dr. Asllan Zemanit për armatimin, veshjen dhe organizimi e prapavijës në Luftën e Dibrës u fokusua tek krijimi i traditës ushtarake. Të tjera kumtesa vijuan nga prof. asoc. dr. Bernard Zoto për dukuri të artit ushtarak në Luftën e Dibrës; dr. Sali Kadria për profilin e nacionalizmit shqiptar në kontekstin e Luftës së Dibrës; dr. Dritan Murrja për krijimi i prefekturës së Drinit për mbajtjen e zgjedhjeve; Zabit Lleshi për betejën në Grykën e Vogël kundër serbëve në vitet 1912-1921 dhe Ali Hoxha për disa aspekte nga kryengritja e shtatorit 1913.

Në këtë sesion shkencor kishte referimin e tij edhe prof. dr. Halim Purellku, i cili nuk ishte i pranishëm, por tema e tij do të botohet në përmbledhjen e posaçme të kësaj konference.

Abdurahim Ashiku do të mbante temën e tij mbi jehonë e kësaj lufte në shtypin e kohës, por edhe kjo nuk u lexua për arsye kohe, ndërsa u lexua një mesazh i tij drejtuar konferencës.

Korresp. Rr.A.

Materialet e plota do të botohen në numrat në vazhdim në gazetën "Rruga e Arbërit" si dhe në një botim të posaçëm.
Në qoftë se dëshironi të bëheni pjesë e projektit të botimit, mund të komunikoni për më shumë informacion në numrin 069 20 68 603.

POSTA SHQIPTARE
Pajtohu në gazetën
RRUGA E ARBËRIT
pranë çdo filiali të
POSTËS SHQIPTARE
në të gjithë Shqipërinë.
Një pajtim vjetor kushton
600 lekë.

Bëj pajtimin tënd me
PayPal
përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Mbështetja financiare përmes pajtimeve është mënyra e vetme dhe më e mira për një gazetë të lirë në shërbim të lexuesve.

PËRSHËNDETJE NË EMËR TË SHOQATËS "ÇIDHNA DHE KASTRIOTËT"

"Kjo konferencë për luftën 9-vjeçare është nder dhe vlerësim i veçantë për Dibrën"

Nga **MUSTAFA TOLA**



I nderuar Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, z. Skënder Gjinushi,

Të nderuar Akademikë, profesorë, historianë dhe studiues,

Të nderuar pjesëmarrës,

Kam nderin që në emër të Shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët" të përshëndes punimet e kësaj konference kushtuar 100-vjetorit të luftës së Dibrës, për liri dhe shtet kombëtar.

Falënderoj me këtë rast, Kryetarin e Akademisë së Shkencave, z. Skënder Gjinushi, i cili pas propozimit të shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët", mori përsipër organizimin dhe përgatitjen e kësaj konference shkencore.

Mbajtja e kësaj konference me këtë nivel akademikësh dhe historianësh për luftën 9-vjeçare të dibranëve është nder dhe vlerësim i veçantë për Dibrën, për gjakun që ata derdhën, djegiet, shkatërrimet, vuajtjet dhe plagët e rënda fizike e shpirtërore, sakrificat, shpërnguljet masive me përmasa gjenocide që kurrë nuk mund të harrohen.

Në vigjilje të shpalljes së pavarësisë, kur Vlora përgatitej të ngrinte flamurin, Dibra ishte përfshirë nga flakët e luftës kundër serbëve, ndërkohë që në krah të Ismail Qemalit ishin dy dibranët e shquar, Vehbi Dibra e Dom Nikoll Kaçorri. 2000 dibranë të tjerë vullnetarë luftonin heroikisht për mbrojtjen e Shkodrës nga Malazezët.

Nëntë vjet luftëra të pandërprerë, që me 26-27 mars të vitit 1912 në Arras të Dibrës deri në betejën vendimtare të Lanë-Lurës më 26-28 tetor 1921, e detyruan ushtrinë e Jugosllavisë së parë të tërhiqet.

Kancelaritë europianë hoqën dorë nga marrëveshjet e fshehta për copëtimin e Shqipërisë. Konferenca e Ambasadorëve njohu kufijtë e Shqipërisë londineze më 9 nëntor 1921. Plagën më të madhe e mbajti Dibra, me ndarjen padrejtësisht të saj.

> Mbajtja e kësaj konference me këtë nivel akademikësh dhe historianësh për luftën 9-vjeçare të dibranëve është nder dhe vlerësim i veçantë për Dibrën, për gjakun që ata derdhën, djegiet, shkatërrimet, vuajtjet dhe plagët e rënda fizike e shpirtërore, sakrificat, shpërnguljet masive me përmasa gjenocide që kurrë nuk mund të harrohen.

Duke e mbyllur, dëshiroj t'ju uroj punime të mbarë kësaj konference dhe kemi besimin e plotë se konkluzionet e saj do të jetë një pikë referimi e rëndësishme për evidentimin e kësaj lufte dhe rolin e saj në historinë e Shqipërisë.

Abdurahim Ashiku: Është koha për një memorial që i bën nder Dibrës mbarë

Endjej si obligim qytetar që t'ju përcjell respektin tim për nismën me të vërtetë madhore që arritët ta realizoni: 100 vjetorin e betejës historike të Lanë-Lurës dhe 100 vjetorin e vendosjes së kufijve që edhe sot kemi, me veprimtari të gjëra që nga rivendosja e lapidarit të Lanë-Lurës, Konferencës Shkencore në Peshkopi dhe tash të Konferencës Shkencore "100 VJET NGA LUFTA E DIBRËS", Tiranë, 20 dhjetor 2021.

Ju falënderoj për ftesën që më bëtë, ftesë që kishte brenda edhe shpenzimet e udhëtimit dhe të fjetjes.

E kisha me dëshirë të madhe ardhjen, kumtimin e punimit tim të hershëm "Kryengritja dibrane e shtatorit 1913 në shtypin e kohës", takimin me shokë e miq, shkëmbimin e mendimeve për veprimtari të tjera në vlerë të vendlindjes sonë, Dibrës, të kësaj e asaj ane të kufirit shqiptaro-shqiptar, të së sotmes dhe të ardhmes së saje, në veçanti të mbrojtjes së ditës nga "serbi" i ri, "serb" që e kemi brenda vetvetes, "serb" që ka vendos "artilerinë e rëndë" në Skavicë, për ta zhytë e mbytë Dibrën, për ta qit fare e për ti përcjellë njerëzit muhaxhirë si në vjeshtën e parë 1913.

E kisha dëshirë që tu bëja thirrje vlerave shkencore të Dibrës dhe më gjerë për ti thënë "JO SKAVICËS".

Do të desha që ti propozoja Konferencës ngritjen e një kompleksi të madh historik të kryengritjes dibrane të 20 shtatorit 1913 me në qendër pesë dibranët që siç thotë gazeta "Përlindja e Shqipënies" vjeshtë e parë 1913, 18/1 me titull "Luftimet e shqiptarëve kundër serbëve"

"Më parë se të vijnë luftëtarët në Dibrë, ushtria serbe burgoi tetëdhet veta nga paresia e vendit, me qëllim që t'i vrasin dhe të nesërmen, Kur u rradhuan për me i plumbos, i arritën Malësorët, andaj s'munden me i vra të gjithë, por veç pesë shpirt.

Këta janë ata që ranë dëshmorë për lirimin e atdheut të vet, të cilëve historia meriton t'i shkruaj emënat e tyne për një kujtim të përjetshëm: Sheh Hyseni, Sadullah Strazimiri, Ramiz beu, Karafil beu, Numan Efendiu. U ndrittë shpirti".

Mendoj se ka ardhë koha që Bashkia e Peshkopisë në bashkëpunim me Komunën e Dibrës së Madhe, në Kështllanë e Dibrës ku ranë dëshmorët të hapin themelet e një memoriali që i bën nder qytetit, Dibrës mbarë.

Mendoj se edhe mbështetja financiare, nisur nga degëzimi biologjik i dëshmorëve, do të jetë e lehtë.

Më vjen keq, nuk mundem me ardhë. Një problem shëndetësor ma këput këmbën, por jo shpirtin për të qenë mes jush në këtë ngjarje që unë e quaj Festa më e madhe historike e Dibrës e të gjitha kohëve.

Me respekt
Abdurahim Ashiku
Athinë 17 dhjetor 2021

konferenca

"Kjo ishte Dibra e Dom Nikollë Kaçorrit dhe Vehbi Dibrës, të cilët Ismail Qemali i zgjodhi njërin nënkryetar të qeverisë dhe tjetrin kryemyfti të meshihatit mysliman shqiptar... Kjo ishte Dibra e Jashar Erebarës dhe Isuf Xhelilit; e Osman Pacit - Selam Musait dibran; kjo ishte Dibra e atyre që lanë malet e bajraqet dhe u bashkuan nën flamurin e të parëve."

Gjinushi: **Është koha** që në vend të historisë folklorike **të kemi historinë e librave**

Akademik Skënder Gjinushi, në fjalën e tij, pasi përshëndeti të pranishmit dhe përgëzoi institucionet bashkëpunuese për organizimin e konferencës shkencore "100 vjet nga Lufta e Dibrës", tha: "Kjo konferencë zhvillohet në vijim të veprimtarive të tjera për ngjarje jubilare që lidhen me dekadën e parë të shtetit shqiptar pas Shpalljes së Pavarësisë. Kemi përkujtuar e nderuar 100-vjetorin e themelimit të shtetit, 100-vjetorin e krahinës autonome të Korçës, 100-vjetorin e Kongresit të Lushnjes, 100-vjetorin e Luftës Kombëtare të Vlorës dhe sot jemi për të vlerësuar e nderuar 100-vjetorin e Luftës së Dibrës.

Kjo është dekada gjatë së cilës ndodhi procesi historik i kalimit nga shpallja e Pavarësisë tek njohja dhe rikonfirmimi i saj. Dhe në këtë kontekst Lufta e Vlorës dhe Lufta e Dibrës kanë qenë ngjarje që e bënë pavarësinë të vërtetë, sepse i kthyen shtetit shqiptar sovranitetin në gjithë territorin e tij, penguan copëtimin e vendit dhe vendimet e padrejta për rishikimin e kufijve të Shqipërisë caktuar më 1913.

Ashtu siç Lidhja Shqiptare e Prizrenit përgatiti Shpalljen e Pavarësisë, ashtu Lufta e Vlorës dhe ajo e Dibrës vulosën vetë pavarësinë.

Lufta e Dibrës qe një luftë popullore, që shfaqi të njëjtat ndjenja e veprime atdhetare si dibranët që kishte në krah themeluesi i shtetit shqiptar Ismail Qemali: dom Nikollë Kaçorri e Vehbi Dibra. Figura të tilla si Elez Isufi e Isuf Xhelili, Ismail Strazimiri, Jashar Erebara, Osman Paci, janë të përmasave kombëtare dhe meritojnë nderimin tonë.

Lufta e Dibrës dëshmoi se historikisht Shqipërinë e kanë dashur "të madhe" vetëm nëse do të ishte nën sundim dhe pavarësinë e saj kanë qenë të detyruar ta njohin vetëm kur dikush tjetër ka tentuar të shtrijë fuqinë e vet ushtarake dhe regjimin e pushtimit".

Më poshtë po paraqesim fjalën e plotë të Kryetarit të Akademisë së Shkencave, Skënder Gjinushi.

* * *

Më së pari ju uroj mirëseardhjen në këtë veprimtari, e cila - e shoh me vend për ta theksuar - organizohet për herë të parë në dhe nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë kushtuar 100-vjetorit të Luftës së Dibrës, një prej faqeve të ndritura të qendresës popullore dhe të përpjekjeve heroike të shqiptarëve për mbrojtjen e territoreve të veta dhe për pavarësimin e vendit të tyre.

Që prej afro një dekade jemi në kohën e 100-vjetorëve: prej shpalljes së Pavarësisë, çlirimit të krahinës autonome të Korçës, Kongresit të Lushnjes, Luftës Kombëtare të Vlorës dhe tani jemi në vitin e nderimit dhe përkujtimit të 100-vjetorit të luftës heroike të dibranëve, një luftë që zgjati gati dhjetë vjet dhe i riktheu tërësinë tokësore Shqipërisë, në kufijtë që kishin caktuar fuqitë vendimmarrëse në vitin 1913.

Periudha ndërmjet 28 nëntorit të vitit 1912 dhe 10 dhjetorit të vitit 1921, me ngjarjet njëra më e rëndësishme se tjetra mes tyre, është prova më e rëndësishme historike për ndërlikimet dhe vështirësitë që pati procesi i papërsëritshëm i kalimit nga shpallja e Pavarësisë tek vetë pavarësimi kombëtar, që ndodh një herë në histori.

Vetëdija kombëtare e dibranëve dha dëshminë më të rëndësishme të saj gjatë asaj dekade jo vetëm në luftën vetëmbrojtëse, por edhe me pjesëmarrjen e vullnetarëve të saj



Nderim shqiptarëve atdhetarë të luftës së Dibrës, tani është koha që në vend të historisë folklorike të kemi historinë e librave, dhe kjo konferencë për këtë qëllim është organizuar.

Jam i vetëdijshëm se të gjithëve ne këtu në këtë sallë na mundon pyetja: Pse kaq vonë të flitet për luftën e Dibrës? Për këtë pyetje do të japin përgjigje me argumente historianët që kanë mbrojtur doktorata e kanë shkruar monografi. Por ka diçka për të thënë edhe në këtë fjalë hyrëse. Ekziston një analogji simetrike midis mënyrës si është paraqitur në histori lufta e Vlorës, që ishte një luftë kombëtare, dhe luftës së Dibrës, që ishte një luftë territorial-krahinore për të njëjtin qëllim. Në pikëpamje të historiografisë tradicionale, nëse nuk ishte verifikuar i njëjti qëndrim qartësisht atdhetar edhe në luftën antifashiste, nuk ishte e mundur të ndriçohej tërësisht merita e atyre që kishin bërë rezistencën më 1920 ose më 1921. Ky ishte qëndrimi ideologjik-klasor që përjashtonte në kriter nga historia bashkë me parësinë e Dibrës, prej Kaloshëve e Karahasanëve që bënë luftë, deri te Gjoçi e Mena i Lurës; prej Dacit të Kalisit e Litës së Kalasë së Dodës, deri tek Maqellara, Ndoka, Dema e Spata, për të përmendur vetëm disa prej tyre.

në luftën e Vlorës dhe në mënyrë të veçantë me pjesëmarrjen e organizuar në mbrojtje të Shkodrës e në rezistencën popullore të Lumës ndaj së njëjtës ushtri pushtuese.

Dy luftëra ballkanike dhe alternimi i ushtrive të dy aleancave më të fuqishme ushtarake europiane të dy krahëve ndërluftues gjatë Luftës së Parë Botërore janë thuajse e gjithë historia e Dibrës në dekadën e dytë të shekullit të 20-të. Por asnjë nga këto ushtri nuk shkaktoi aq plagë, shkatërrime dhe lëndime sa ajo e Jugosllavisë së parë fqinje, e ish-mbretërisë serbo-kroato-sllovene, e cila, e inkurajuar nga prishja e kufijve në Ballkan, nxitoi të shtrinte forcën e armëve të saj përgjatë tërë luginës së Drinit, për të realizuar projektin famëkeq të shtetit në formë korridori, që do t'i ndante territoret historike shqiptare mes për mes.

Kryengritësit e Dibrës, bashkëluftëtarë të gjeneralit me shajak, siç e patën cilësuar kanceleritë e Perëndimit Elez Isufin; në traditën e qëndresës së Kastriotëve; në traditën e kryengritjes së çidhnakëve të Nokës në shekullin XVIII; në traditën e besëlidhjeve historike shqiptare; morën vendime që mund të vlerësohen si të një përgjegjësie qeveritare nëpër kuvendime të urta, veçanërisht në kuvendin e Arrasit, ku u mor vendimi për të mos e pushuar rezistencën deri në dëbimin e ushtarit të fundmë të pushtuesve fqinjë. E tillë është historia parashtetërore e Shqipërisë: nga lidhjet dhe besëlidhjet, kuvendet dhe kongreset, lindi vetëdija e shtetësisë e zotësia e vetëqeverimit.

Gjatë nëntë vjetëve të qëndresës së vullnetarëve dibranë kundër pushtimit të huaj - dhe duhet thënë të një qëndrese që mbeti gati-gati e izoluar prej vatrave të tjera të rezistencës - shkëlqeu figura e Elez Isuf Ndreut; që është kthyer në një shëmbëlltyrë të saj. Kjo periudhë ka qenë prova e dritësimit edhe për shumicën e atyre familjeve të mëdha, që zakonisht janë quajtur parësia e Dibrës, të cilave më vonë u janë lënë në heshtje meritat e një kohe dhe u janë theksuar qëndrimet e qortueshme të një brezi tjetër. Këtu nuk është vendi për t'u ndalur në lista të emrave të tyre, por nuk mund të mos evokojmë rëndësinë që pati përkrahja pa lëkundje e vijës së qëndresës, e vullnetarizmit për të mbrojtur vendin, që nga Maqellara e Golloborda, deri në Sllovë, në Reç e Dardhë, në Çidhën e Lurë.

Siç na kanë dëshmuar protagonistë të rendit parësor të epokës, si heroi i rrallë i dy luftërave botërore Ismail Strazimiri, shumë të rënda kanë qenë humbjet, shumë e vështirë ka qenë lufta, por edhe më i vështirë ka qenë bashkimi. Rryma e ndikime nostalgjike për sulltanin që kishte perënduar, për perandorinë e shembur dhe për Sherjatin; sabotatorë esadistë e afër tyre dhe njerëz tinëzarë të shitur tek ushtritë sunduese; që do të dilnin më hapur në një kohë pak më të vonshme, bënë ç'mundën për të prishur punë, për të

Vetëdija kombëtare e dibranëve dha dëshminë më të rëndësishme të saj gjatë asaj dekade jo vetëm në luftën vetëmbrojtëse, por edhe me pjesëmarrjen e vullnetarëve të saj në luftën e Vlorës dhe në mënyrë të veçantë me pjesëmarrjen e organizuar në mbrojtje të Shkodrës e në rezistencën popullore të Lumës ndaj së njëjtës ushtri pushtuese.

dobësuar luftën e dibranëve kundër ushtrive pushtuese, e cila, megjithatë, me betejën e lavdishme të Lanë-Lurës, arriti ta shndërrojë gjithë situatën në favor të vet dhe, më së fundi, në dhjetor të 1921-shit, të çlirojë tërë territorin e krahinës dhe t'ia kthejë atë nën sovranitet qeverisë dhe kuvendit që kishte dalë mbi bazën e akteve të miratuara nga Kongresi i Lushnjes. Kjo ishte Dibra e Dom Nikollë Kaçorrit dhe Vehbi Dibrës, të cilët Ismail Qemali i zgjodhi njërin nënkryetar të qeverisë dhe tjetrin kryemyfti të meshihatit mysliman shqiptar, duke hedhur hapin e parë historik të pavarësimit të xhamisë shqiptare, një hap po aq i rëndësishëm mëvetësues sa dhe shpallja e autoqefalisë së kishës ortodokse dhe mëvetësimi i bashkësisë bektashiane. Kjo ishte Dibra e Jashar Erebarës dhe Isuf Xhelilit; e Osman Pacit - Selam Musait dibran;kjo ishte Dibra e atyre që lanë malet e bajraqet dhe u bashkuan nën flamurin e të parëve.

Jam i vetëdijshëm se të gjithëve ne këtu në këtë sallë na mundon pyetja: Pse kaq vonë të flitet për luftën e Dibrës? Për këtë pyetje do të japin përgjigje me argumente historianët që kanë mbrojtur doktorata e kanë shkruar monografi. Por ka diçka për të thënë edhe në këtë fjalë hyrëse. Ekziston një analogji simetrike midis mënyrës si është paraqitur në histori lufta e Vlorës, që ishte një luftë kombëtare, dhe luftës së Dibrës, që ishte një luftë territorial-krahinore për të njëjtin qëllim. Në pikëpamje të historiografisë tradicionale, nëse nuk ishte verifikuar i njëjti qëndrim qartësisht atdhetar edhe në luftën antifashiste, nuk ishte e mundur të ndriçohej tërësisht merita e atyre që kishin bërë rezistencën më 1920 ose më 1921. Ky ishte qëndrimi ideologjik-klasor që përjashtonte në kriter nga historia bashkë me parësinë e Dibrës, prej Kaloshëve e Karahasanëve që bënë luftë, deri te Gjoçi e Mena i Lurës; prej Dacit të Kalisit e Litës së Kalasë së Dodës, deri tek Maqellara, Ndoka, Dema e Spata, për të përmendur vetëm disa prej tyre.

Sot është dita të nderojmë gjithashtu gjithë ato familje të vjetra të Tiranës së varfër të dekadave të para të shekullit të kaluar, të cilat me bujari u dhanë shtëpi dhe truall dibranëve të dëbuar për shkak të luftës, sidomos më 1913 dhe më 1921, duke formuar në kryeqytet një bashkësi të qëndrueshme dhe të integruar, një Dibër tjetër rreth e qark nesh, duke dëshmuar edhe me këtë akt se tashmë Shqipëria ishte një dhe e të gjithëve dhe se vetëdija kombëtare kishte fituar hegjemoninë e vet mbi çdo përbërëse tjetër të identitetit të njeriut dhe të popullit.

Nderim shqiptarëve atdhetarë të luftës së Dibrës, tani është koha që në vend të historisë folklorike të kemi historinë e librave, dhe kjo konferencë për këtë qëllim është organizuar. Faleminderit për vëmendjen dhe suksese kumtuesve.

Rruga e Arbërit nr. 184

intervistë

Në roman u kushtohet vend i rëndësishëm diskurseve etike të marrëdhënieve të artistit me të vërtetën dhe mënyrës sesi duhet të shprehet e vërteta, pa e shkatërruar artistin, sikundërse dhe marrëdhëniet e shkrimtarit me misterin e pashpjegueshëm të krijimit. Samuil Ismari dhe miku i tij Dario S. janë të përpirë nga misteri i shtatzënisë së Ljuba Borisovnës.

Agron Tufa: "Ngjizja e papërlyeme" është një sagë

Bisedoi: Bujar Hudhri


Foto ©: Blerta Celibashi

I dashur Agron, romanin tuaj voluminoz "Ngjizja e papërlyeme", që do të paraqitet për herë të parë në stendën "Onufri" në Panairin e Librit, kam pasur fatin ta lexoj në dorëshkrim. Qysh në prologun e tij, leximi më solli në mendje tregimin e shkurtër të Kadaresë "Vdekja e gruas ruse". Por, në qoftë se mundësitë e tregimit janë të kufizuara, proza juaj (shumë) e gjatë na jep, mbase për herë të parë në detaje, vuajtjet, burgosjet, internimet, divorcet e vajzave ruse që erdhën pas djemve shqiptarë mijëra kilometra larg vendit të tyre. Një fakt që na bën të ndihemi keq, si nënshtetas të këtij vendi, kur diktatura burgosi si agjente këto nuse, ndërkohë agjentët e vërtetë të KGB-së ishin në instancat më të larta të shtetit shqiptar. Doja t'ju pyesja fillimisht: Mos është kjo një nga arsyet kryesore që e shkruat këtë roman?

Ka qenë një ngacmim i hershëm ideja për t'iu qasur thelbit tragjik të qindra fateve njerëzore ku, tok me divorcin ideologjik, diktatura nuk kurseu ndarjen e përjetshme të burrave me gratë dhe fëmijët e përbashkët nga këto martesa. Diktati politik i partisë-shtet për herë të parë në historinë njerëzore ndërhyri në shtretërit bashkëshortorë për t'i dëbuar burrit gruan e vet. Një gjë të tillë të dhunshme nuk e ndeshim as në subjektet e miteve antike. Pra, u guxua të preket shenjtëria e shenjtërive, kurora e martesës, sakramenti, rrjedhimisht, familja. Si nga etika religjioze, ashtu dhe nga etika mondane, kjo ishte një katastrofë shokuese që la plagë të pashërueshme dhe pengje të përjetshme në shpirtrat e burrave, grave dhe fëmijëve. Historikisht është e dihet: direktiva e pushtetit komunist, fill pas prishjes së marrëdhënieve me BRSS-në, qe prishja e martesave shqiptaro-ruse, kthimi i nuseve ruse në atdhe, që përbën një akt zhburrnimi për burrat shqiptarë (që s'duhej e s'duhet falur) dhe, njëkohësisht, pohimi i besnikërisë pa kushte të këtyre burrave para Partisë. Por jo gjithkush e pranoi këtë zhburrnim. Martini, heroi i pushkatuar i romanit, përfaqëson imazhin përmbledhës të atyre që nuk u bindën, nuk deshën të zhburrnohen.

Kur isha student në Institutin "Gorki", më qëlloi të lexoja në revistën "Nash Sovremenik" (Bashkëkohësi ynë) romanin autobiografik të një shkrimtareje me dy tituj, rusisht dhe shqip: "Zhdu tebja"/ "Të pres". Një rrëfim dhe përjetim i dhimbshëm i ndarjes së autores me të shoqin shqiptar në Tiranën e vitit 1961. Më vonë pata rastin të shihja në festat kombëtare të ambasadës sonë në Moskë shumë gra dhe bijtë e bijat e tyre që i kishin ndarë dhunshëm nga burrat/etërit e tyre. Kam parë, gjithashtu, burra pleq që u kishin dhënë besën nuseve të tyre kur i ndanë, se do të ribashkoheshin. Këta burra pleq, edhe pse Partia i kishte shtrënguar të martoheshin, madje të bënin sa më shumë fëmijë, me rastin e parë që u dha, në vigjiljen e rrëzimit të diktaturës, u arratisën, si fillim në Sofje, mandej me tren deri në Moskë, ku i prisnin njëmend nuset e tyre, sipas besatimit. Veçse nuset ruse vërtet nuk qenë martuar (flas të paktën për rastet që kam njohur vetë). Drama të rënda që shkojnë përtej legjendave. Përfytyroni, gruaja hap derën e apartamentit në orën 21.00 të mbrëmjes dhe befas sheh përballë, pas 31 vjetësh, të shoqin e saj shqiptar të cilit i ka qëndruar në besë: gruas i bie të fikët dhe e dërgojnë në spital. Pas tre muajsh burri i thotë të vërtetën, se atë e kanë detyruar të martohet dhe ai ka braktisur në Shqipëri familjen e vet, gruan dhe 7 fëmijët. Gruas sërish i bie të fikët dhe vdes në spital.

Momenti i dytë dhe shtysë për t'iu kthyer kësaj tragjedie kanë qenë regjistrimet e të mbijetuarve nga kampet dhe burgjet e komunizmit, që i bënim me poeten Luljeta Lleshanaku për ISKK, ndër të cilat edhe rrëfimet e nuseve ruse, që duruan kalvarin e burgjeve dhe internimeve, por nuk u ndanë. Sigurisht, disa nga gratë që e kaluan këtë kalvar të hidhur kanë shkruar dhe memuaret e tyre në gjuhën amtare, e ndonjë edhe është përkthyer.

Për fat të keq, nëse përjashtojmë tregimin e trishtë të Kadaresë që përmendët ju, "Vdekja e gruas ruse", dhe një skenar filmi po të Kadaresë, "Sorkadhet e trembura", u gjet madje dhe regjisor rus që do ta realizonte (s'di pse nuk u finalizua ky projekt), gjë tjetër në letërsinë tonë nuk është shkruar. Në një rrafsh të përgjithshëm ky, pa dyshim, ishte një turp kombëtar dhe tjetërsim i neveritshëm i traditës sonë, për të cilën duhej folur, por letërsia i qaset dramës në vetë të parë, duke i shpërfillur pyetjet "çfarë" dhe "pse"; letërsisë i intereson pyetja "si": si ka mundur të ngjasë kjo gjëmë e padëgjuar deri në regëtimat e drithërimat më të fundit?

Shumë shkrimtarë dhe artistë shqiptarë që përfunduan studimet në BS, kanë pasur histori dashurie, fejesa, martesa, divorce me vajza ruse. Ja, për shembull, duke bërë një paralelizëm me një nga personazhet e romanit tuaj, e përfytyroj dhimbjen e një poeti si Dritëro Agolli kur përcjell në Rinas gruan e tij ruse së bashku me djalin e tyre të vetëm. Por nuk di që Dritëroi të ketë shkruar për këtë temë. Mos ishte kjo një tabu? Mos ndoshta kjo dhimbje nuk i shkonte frymës anti-BS dhe kjo në letërsi ishte gati e pamundur? Por, megjithatë, pas vitit 1990 kjo temë nuk ishte më e rrezikshme. Si mendoni ju?

Ajo që më habit edhe mua është se nuk kanë shkruar për këtë "zhburrnim" as vetë shkrimtarët. I bie, paradoksalisht, në përgjithësi, se shumë shkrimtarë tanët të viteve gjashtëdhjetë nuk kanë shkruar asgjë që të ketë lidhje me ndonjë të vërtetë, shoqërore qoftë ajo apo individuale, e aq më tepër për një të vërtetë të tillë kaq thellësisht private e të dhimbshme. Nuk kam një përgjigje racionale, por Zoti na faltë për nja dy-tri hamendje që kam rreth kësaj heshtjeje.

E para, mendoj se ka të bëjë me një peng të parrëfyeshëm, një ndjenjë bezdie e turpi që "agjencitë e nënvetëdijes" e fshijnë me "regjim heshtjeje" diç të pakëndshme që u kujton minutat e dobësisë, kujtesën e turpshme. Pse? Se ata iu përgjigjën flakë për flakë direktivës së Partisë, sikundër i përgjigjeshin burrat autoritetit paternal në Kanun, për ta ndarë gruan kur shkel normat tabu. Veçse këto gra e nuse të reja s'kishin bërë asgjë të turpshme, siç kam pasur rastin të dëgjoj intervistat dhe jetëshkrimet e tyre. Madje, ato kishin të ngulitur një bindje romantike, të pastër apo naive në vetëmohim, për t'i ndjekur burrat që donin deri në fund të botës, ashtu si gratë e Dekabristëve ndoqën burrat e tyre në Siberi.

E dyta, ka shumë gjasa që, paraprakisht, me paramendim, Sigurimi të ketë ndërhyrë, ndërkohë, të ketë siguruar fakte apo simulime faktesh me situata kompromentuese për prestigjin dhe nderin e këtyre grave. Varet pastaj nëse këto "kompromentime" që hidhnin hije mbi nderin e tyre u janë thënë burrave të tyre para apo pas ndarjes. Baza për të menduar kështu ka, madje të dokumentuara.

E treta, ka të bëjë me ekuilibra të brishtë mes burrave dhe grave që zëvendësuan nuset e dëbuara ruse, ka të bëjë me obsesivitetin e tyre dhe shkallën e trysnisë që do të ushtronin mbi burrat këto gra, nëse burrat e tyre do të guxonin të zhvarrosnin historitë e një romantike të dënueshme në sfondin e tashëm familjar.

Fakti që nuk shkruan, pavarësisht para apo pas vitit nëntëdhjetë, nuk përligjet me asgjë. Shkrimtari shkruan edhe për sirtar, në çdo kohë. Aq më tepër për rastin në fjalë që ishte një llogari e hapur dhe e ndjeshme me ndërgjegjen. Por kjo tashmë është një pyetje tjetër që prek raportet e shkrimtarit shqiptar me ndërgjegjen e vet dhe se kjo i përket sociologjisë së moralit.

Keni mbaruar Institutin e Letërsisë së Huaj "Gorki" në Moskë. (Në vitin 2010, ndërsa shoqëroja Kadarenë në Moskë, insistova të shihja dhomën e tij në konviktin e institutit. Atje mësova se pikërisht në atë dhomë keni jetuar edhe ju gjatë studimeve.) A mund të na thoni se ç'gjë tjetër u kujtonte Kadarenë (apo shkrimtarë të tjerë, si S. Spasse, D. Siliqi, Dh. Xhuvani): lëndët, pedagogët…

As vetë nuk e dija kur shkova më 1994, por duke rilexuar "Ftesë në Studio" dhe "Muzgu i perëndive të Stepës", që i kisha me vete, kur Kadareja përshkruan atmosferën surreale të konviktit të Institutit "Gorki" (në fakt, ashtu e gjeta edhe unë, madje edhe më surreale), përmend aty edhe numrin e dhomës së tij. Siç isha me libër në dorë, u ngrita dhe dola jashtë të shoh në derë: i njëjti numër! Ua thashë këtë fakt bashkëstudentëve shqiptarë, madje njëri më ofroi një shumë markash gjermane për t'i ndërruar dhomat, por miku im, Korab Hoxha, më tha: po më dëgjove mua, Gon, mos e shkëmbe.

Për Kadarenë dhe shkrimtarët shqiptarë të brezit të fundit të viteve gjashtëdhjetë pata rast të flas gjatë me zyshën time të rusishtes, Magdalena Rubianovna, një zonjë me origjinë armene në prag të pensionit; e kishte filluar vitin e parë të mësimdhënies pikërisht me shkrimtarët shqiptarë, si Aliabdi Hoxha (ajo i kishte ndihmuar atij të përkthente romanin "Një vjeshtë me stuhi"), Dhimitër Xhuvani, Ibrahim Uruçi dhe veçanërisht dy, të cilët ajo i mbante mend më mirë e më pyeste për ta: Ismail Kadare dhe Drago Siliqi. Për Kadarenë kishte dëgjuar dhe kishte lexuar tashmë tri vepra të përkthyera në "Inostranaja Literatura": "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Sjellësi i fatkeqësisë" dhe "Dimri i madh". Madje, në bazë të këtyre veprave të përkthyera në rusisht, pata bërë në vit të katërt shpërndarjen e tyre ndër studentë rusë e të huaj dhe zhvillova një seminar rreth tyre me krijuesit e Institutit "Gorki". Për Dragon, që gjithashtu e mbante mend dhe e kishte pasur shumë për zemër, zysha qau kur i fola për aviokatastrofën e tij mbi shkretëtirat mongole. Kjo zonjë e mrekullueshme, ndjesë pastë, më thoshte: shih si u përftua me mua një kompozicion unazë: e nisa vitin e parë të mësimdhënies me shkrimtarët shqiptarë, Kadare me shokë, dhe po e mbyll po me shkrimtarë shqiptarë.

Rektori i atëhershëm i Institutit "Gorki", Sergej Jesin, gjithashtu njëfarë shkrimtari, tregoi interes të madh gjatë një darke kur i fola për "Muzgun e perëndive të Stepës" dhe donte me çdo kusht ta botonte, si duket për ta vënë si simbol të Institutit, pasi nuk dinte të kishte shkruar kush tjetër një roman për Institutin "Gorki".

Një nga personazhet kryesore të romanit është Martin Gega. Herë pas here, gjatë leximit më duket sikur Martini është alter egoja juaj. Dhe në vijim të kësaj pyetjeje: cili është dallimi midis një studenti të 1960-s në Rusi me studentin Agron Tufa tridhjetë e ca vjet më pas? A mund të na flisni nga përvoja juaj jetësore për vajzat ruse apo nuk do të donit ta ndani këtë me lexuesit tuaj?

Në njëfarë mënyre po, është një alter ego e spostuar në kohë, në rrethana tragjike, në të cilat unë, ju, çdo lexues normal, do të kishim mbetur të martirizuar, jo prej paaftësisë për t'u përshtatur, por për dinjitetin thelbësor që vë në diskutim "lulen e nderit" burrnor, pa të cilën jeta humbet kuptim e përmbajtje. Një pjesë e madhe e protagonistëve të romanit kanë frikëra fizike dhe bëjnë çfarëdo kompromisi, capak të tjerë frikën më të madhe kanë humbjen e dinjitetit dhe poshtërimin.

Por një student i viteve nëntëdhjetë, siç isha unë, pas rënies së mureve ideologjike, gjendej në një hapësirë lirie të shfrenuar dhe indiference, jashtë konteksteve kohore

Romani, tetralogjia "Ngjizja e papëlyeme", është ndërtuar në bazë rrathësh interferues rrëfimorë, gjithsej katër, me një prolog dhe epilog të zhvendosur në kohën e sotme që legjitimon instancën nga ku shkarkohet rrëfimi dhe një intermexo, "Orë pa akrepa", që na jep idenë e palëvizshmërisë, pezullimit të rrjedhjes së Kohës. Rrathët rrëfimorë janë romane që kanë në epiqendër një protagonist, i/e cili (cila) ose rrëfen në vetë të parë, ose na jepet në veprim përmes vetës së tretë.

rrëqethëse e shoqërisë shqiptare në fillim të viteve '60

e koniunkturore të viteve gjashtëdhjetë. Detyra ime ka qenë të mos harroja qëllimin kryesor përse gjendesha aty, të bëja më të mirën e mundshme duke përfituar sa më shumë kulturalisht për çfarë më interesonte, të disiplinoja kaosin që të gëlltiste lehtë me aventurat, pleksjet në histori ekscentrike, të ruaja pavarësinë time. Krahas studimeve në "Gorki" e më vonë në Institutin e Kulturave Europiane, në vitet 1996-2001 isha pedagog i gjuhës dhe letërsisë shqipe në Institutin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare (MGIMO), çka më jepte pavarësi financiare për të jetuar, për të blerë libra, për të shkuar në teatër, për të udhëtuar etj.

Vajzat ruse, të paktën të rretheve letrare e filologjike me të cilat kisha të bëj, mendoj se kanë qenë të njëllojta me ato të viteve gjashtëdhjetë, pa shumë luhatje, nëse flasim për natyrën romantike e sentimentale. Duheshin bërë llogaritë mirë e seriozisht në lidhjet dashurore me to, sepse pasioni dhe shenjtëria karakteristike me të cilën i përkushtoheshin ato një lidhjeje dashurore dhe gatishmëria për të sakrifikuar kishte një bukuri të tmerrshme, tronditëse. Kështu që ishte gjithmonë me rrezik të ishe i përfshirë.

Në roman jepet gjerësisht një nga plagët e shoqërisë shqiptare e shkaktuar nga diktatura: lufta e klasave dhe veprimtaria e egër e aparatit të dhunshëm të Sigurimit. Aftësive dhe talentit tuaj a mund t'i shtojmë edhe mundësitë që keni pasur si drejtor i institutit të krimeve të komunizmit apo pjesëmarrja juaj aktive në mediat e ndryshme? E rrokte fantazia juaj prej krijuesi atë çfarë ndeshët në këto arkiva?

Nuk besoj se e keqja njerëzore do të gjente kund tjetër mishërim më mizor e më të shëmtuar se me këta emisarë të ferrit te ne. Unë flas në roman për përfaqësues tipikë të breznive të pas-Luftës së Dytë Botërore, që ishin "partizanë të orës së fundit" e që u dërguan të studiojnë në institutin famëkeq "Xherxhinski". Janë ata që e mbushën jetën qytetare të viteve gjashtëdhjetë me terror të pandërprerë psikik, duke radikalizuar modelet staliniste të KGB-së në një variant të përbindshëm kriminal shqiptar. Për të ndërtuar topikën e përditshmërisë së terrorizuar shqiptare kam shfrytëzuar arketipa portretesh e bëmash reale të shefave e oficerëve të Sigurimit që, në fakt, zbatonin me një egërsi të pashoqe direktivat e Partisë dhe luftës së klasave. Survejimi i të deklasuarve, gjoja kundërshtarëve, të dyshuarve etj., bëhej në dhjetëra mënyra, sipas praktikave të "planveprimeve" apo "vijës së sjelljes" me skema makabre, të poshtra, të ulëta e të pabesa, deri te burokracitë konceptuale, siç ishte, për shembull, "Libri i shtëpisë", ku ti duhet të shënoje orën dhe datën e vizitës së mysafirit, kohën e qëndrimit dhe bisedën që bëtë. Libri kontrollohej fletë për fletë, çdo muaj, nga i plotfuqishmi, polici i lagjes. Diçka oruelliane. Sigurimit i ishte lënë një pushtet i pakufishëm dhe shpesh, për arritjen e qëllimeve të tyre, ata i shpërfillnin praktikat, ligjin, të drejtat: njeriu shndërrohej një lodër në duart e tyre, ose ata e kthenin në lodër, si t'u tekej. Mendoj se për shkak të kësaj klime të pandërprerë terrori, qe e pamundur të zhvillohej një përmasë disidence letrare e kulturore në Shqipëri, e ngjashme me disidencën ruso-sovjete apo të demokracive popullore.

Ju e quani këtë roman një tetralogji. Nuk di të ketë të dytë në letërsinë shqipe. Pse e ndiet të nevojshme të përmblidhnit katër romane në një? A ishte kjo diçka e planifikuar që më parë apo rrugës, gjatë procesit të shkrimit, erdhi natyrshëm?

Saktësisht është kjo e dyta, pasi, edhe nëse



i kam menduar fijet e syzhetit më parë, gjatë procesit të shkrimit tek unë mbizotëron stihia instinktive. Romani, tetralogjia "Ngjizja e papëlyeme", është ndërtuar në bazë rrathësh interferues rrëfimorë, gjithsej katër, me një prolog dhe epilog të zhvendosur në kohën e sotme që legjitimon instancën nga ku shkarkohet rrëfimi dhe një intermexo, "Orë pa akrepa", që na jep idenë e palëvizshmërisë, pezullimit të rrjedhjes së Kohës. Rrathët rrëfimorë janë romane që kanë në epiqendër një protagonist, i/e cili (cila) ose rrëfen në vetë të parë, ose na jepet në veprim përmes vetës së tretë. Rrathët interferojnë në ngjarje/variante ngjarjesh, gjykimesh/paragjykimesh, personazhesh e detajesh me rrathët e tjerë (romanet e tjera). Midis tre rrathëve rrëfimorë interferentë derdhen fragmente nga teksti i dorëshkrimit të romanit "Pjella", autori i të cilit, Martin Gega, tashmë është pushkatuar. Këto fragmente të gjata nga dorëshkrimi, të shpërndara në tre rrathë romanorë, e krijojnë mirë idenë e veprës (ndonëse të paplotë) dhe ashtu, të ndërkallura si fragmente, krijojnë trukun e romanit në roman ose, më saktë, iluzionin e një romani të pestë. Në të gjithë rrathët rrëfimorë kemi kallëzime, rrëfenja, novela të mirëfillta, tekste ëndrrash, raporte skrupuloze zyrtare, tekste epistolare deri dhe formula betimesh zyrtare, të cilat përthyejnë vazhdimisht regjistrat narrativë të rrëfimit. Rrethi i çdo rrëfimi përmbyllet duke e lënë protagonistin në një perspektivë të caktuar të udhëtimit të tij.

Romanin nuk e kisha menduar tetralogji, por u përftua organikisht gjatë shkrimit dhe po për hir të këtij organiciteti, duhej botuar në një vëllim. Nuk e di në ka tetralogji tjetër në një vëllim, por kam përshtypjen se romani "Rapsodi kosovare" i Ymer Shkrelit është tetralogji.

Shumë personazhe në roman, për mendimin tim, janë lehtësisht të identifikueshme nga emrat dhe karakteret e tyre dhe doja t'ju përgëzoja për mjeshtërinë tuaj në portretizimin dhe karakterizimin e tyre: Samuil Ismari, Nesho Dragoi, Dritan Agalliu, Dario S., Damjan Shpërdheja etj. Ndërkaq, më lind krejt natyrshëm pyetja se pse e keni ndier të nevojshme ta bëni këtë? Cili është qëllimi juaj në këtë rast? (Zakonisht shkrimtari i pararend një gjëje të tillë dhe e paralajmëron lexuesin se këtu kemi të bëjmë me roman.) Më krijohet përshtypja sikur ju doni ta theksoni posaçërisht identitetin e tyre.

Jeta e tillë është: e tëra një radhë e pasosur me déjà vu: ngjajnë njerëzit, ngjajnë situatat, ngjajnë emrat, pasionet dhe bëmat. Romani është i lirë ta lërë lexuesin t'i bëjë vetë lidhjet asociative, ashtu si në jetë: e rëndësishme është që ligjësitë letrare t'i binden frymës së asaj të vërtete me të cilën rrojnë, veprojnë e shpresojnë protagonistët, të mirë apo të ligj. Sigurisht, dikush me dikë do të ngjajë, se për mishërime letrare të një brezi të caktuar është fjala. Unë nuk e vura klishenë e njohur e të gatshme paralajmëruese, sepse më duket se kështu fyej inteligjencën e lexuesit, i cili e sheh që shkruhet që në kopertinë "roman".

Kadareja zë shumë hapësirë në romanin tuaj. Duke bashkëpunuar me të prej 25 vjetësh, mund t'ju vlerësoj shumë për zotësinë tuaj që e keni bërë aq të rrokshëm, aq të vërtetë për lexuesin. Por do të doja përgjigjen tuaj pse e keni përfshirë në roman? Apo mund të jetë edhe Kadareja një alter egoja juaj (një Skënder Bermema, p.sh.?)

Romani i fundit i tetralogjisë, "Ç'lajme na sjell, Hermes?", përfshin komunitetin e shkrimtarëve të rinj që janë kthyer nga studimet në BRSS dhe vendet e tjera të demokracive popullore.

Samuil Ismari është arketipi i një imazhi letrar në stilin e "portret artisti në rini", që ka shumë përkime me Kadarenë e ri, të sapokthyer nga studimet. Janë vitet kur në letërsi hyjnë me dashuri disa të talentuar, me ëndrra të mëdha për art të ri, ndërkaq që gllënjka e lirisë është iluzion dhe perspektiva e rrugës përpara bigëzohet në mënyrë djallëzore. Për më të talentuarin, Samuil Ismarin, kjo shndërrohet në vuajtje, torturë mendore e shpirtërore. Dialogët e shumtë me mikun e vet, monologët, dyshimet e vazhdueshme, frika dhe revolta e bëjnë të paparashikueshme ndjenjën e perspektivës. Përveç mikut të tij të studimeve, Dario S., ai s'ia ka besën askujt. Mjedisi midis shkrimtarëve të rinj zien nga entuziazmi i shtirë, por në fakt ai është i helmuar nga salierizmi, xhelozia, spiunët e denoncuesit, përfshij edhe të dashurat.

Në roman u kushtohet vend i rëndësishëm diskurseve etike të marrëdhënieve të artistit me të vërtetën dhe mënyrës sesi duhet të shprehet e vërteta, pa e shkatërruar artistin, sikundërse dhe marrëdhëniet e shkrimtarit me misterin e pashpjegueshëm të krijimit. Samuil Ismari dhe miku i tij Dario S. janë të përpirë nga misteri i shtatzënisë së Ljuba Borisovnës.

Çështja e alter egos në këtë rast është e pashmangshme, përderisa personazhi simpatik, shkrimtar i talentuar, gjendet i vetëm mes ujqish gri.

I dashur Agron, nuk gaboj kur shprehem se kjo është kryevepra juaj dhe një nga romanet më të mira të pas viteve '90 në letërsinë shqipe. A mund të na flisni për procesin tuaj krijues? Sa kohë ka zgjatur të shkruarit deri në dorëzimin te ne të dorëshkrimit? Çfarë ka ndikuar së tepërmi në këtë roman, çfarë keni ndier, a ju ka sjellë gëzim, a keni hasur vështirësi deri në përfundim. Dhe në fund titulli: "Ngjizja e papërlyeme". Një mrekulli! Po si erdhët deri këtu dhe a ju duket sikur keni shlyer ndonjë borxh moral për sivëllezërit tuaj krijues të kohëve të vështira të diktaturës?

Faleminderit i dashur Bujar dhe e çmoj shumë mendimin dhe shijen tuaj. Unë ende nuk jam në gjendje të përcaktoj se ku jam me këtë roman. Më mirë është të mos mendosh e të vijosh veprën tjetër (çka po e bëj). Siç thashë në krye, ideja e romanit e ka pasur fillin që kur isha student në Institutin e Letërsisë "Gorki", me disa nxitje të tjera, të mëvonshme. Romanin e kam filluar në dhjetor të vitit 2014 kur isha ftuar për një qëndrim njëmujor në një rezidencë shkrimtarësh në Wannsee, Berlin. Shkrova disa fragmente që m'u dukën pa lidhje dhe e braktisa. Kam provuar edhe disa herë në Tiranë, por ndieja se ky tip romani të donte t'i kushtoheshe me kohë të plotë e të pandërprerë, jo me thërrime të tepruara kohe. Provova sërish vitin e kaluar, por nuk isha i qetë. Romani u shkrua nga 11 qershori i këtij viti deri në 17 shtator, duke shkruar përditë, shpesh me nga 7-8 orë. Ka qenë romani im më i vështirë, pasi duhej përshtatur mrekullia e lindjes misterioze me një përditshmëri të ngjeshur realiste deri në çikërrima. Me romanet e mëparshme e kam pasur shumë më të lehtë. Koha e shkrimit më zgjaste një javë deri në një muaj. Kam ndier pa dyshim gëzim, çlirim dhe një lehtësim të madh jo vetëm nga tirania e një pune të rëndë, ndonëse asnjëherë gjatë procesit të shkrimit nuk e ndieja.

Shkrimi vetë të çliron edhe nga disa stereotipa paragjykimi ose gjykimi të cekët kur flitet për paraardhësit. Nuk besoj se ka pasur kohë më të vështira në planet për të shkruar letërsi të vërtetë sesa vitet e diktaturës komuniste në Shqipëri. Të arrish të shkruash një tregim të mirë, një cikël poezish a poemë të mirë artistikisht apo një roman të shkruar profesionalisht bukur, jashtë dogmës, ky është, pa ekzagjerim, njëmend heroizëm kulturor, rezistenca më e mirë, sepse qëndresa më e mirë është ajo e gjuhës dhe stilit të shkrimit. Dakord, pak, madje shumë pak ka pasur prej kësaj cilësie, por ka pasur dhe është shenjë se diku, dikush ia ka dalë të triumfojë estetikisht me mjetet e gjuhës dhe mjafton për të qenë madhështore. Le ta shpërngulim veten, pra, kur gjykojmë, le ta vendosim shkrimtarin që gjykon nga lartësia e sotme bash në vitet e survejimit të shumëfishtë dhe ta shohim se në çfarë epilepsie ekzistenciale do të përpëlitet. Përmes këtij romani unë kam provuar të kridhem në kohë dhe ta jetoj si në lëkurë përditshmërinë psikotropike të viteve gjashtëdhjetë, të jem njëri nga kolegët e asaj breznie.

Heroi qendror i tetralogjisë është Ljuba Borisovna që mbetet shtatzënë, jo në rrugë shtrati, por në rrethana misterioze, pasi ka gatuar dhe ka ngrënë dorëshkrimin e të shoqit që pushkatohet. Si ta kuptojmë këtë? Plan alegorik?

Është një parabolë, konvencë diskursive në formacionin e ngjeshur e realist të romanit. Ljuba Borisovna nuk do që nga frika ta likuidojë të vërtetën (dorëshkrimin e romanit autobiografik të të shoqit); ajo nuk pranon ta shkatërrojë fizikisht kopjen e vetme të dorëshkrimit, por, në kushtet e ankthit dhe panikut, zgjedh instinktivisht ta gatuajë e ta hajë. Në thelb, përtej gjykimeve dhe teorive të ndërlikuara shkencore që shtjellojnë diskurset e protagonistëve të tjerë të romanit, Ljuba mbetet shtatzënë me të vetmen të vërtetë të papërlyer që ka mbetur – të vërtetën e dorëshkrimit të romanit. Cila është ajo formë, e aftë të dëshmojë herëdokur, pa kompromise të vërtetën se çfarë ngjau? Paradoksalisht, kjo formë e aftë për të dëshmuar është zhanri: romani. Roman quhet fëmija i lindur nga kjo shtatzëni, të cilit pushteti komunist i bën edhe analizat e shtrenjta gjenetike të përkatësisë prindërore. Është biri i kësaj shtatzënie, Romani, ai që na i rrëfen ngjarjet, i pajisur me besimin, kurajën dhe amanetin që ia lë e ëma në shtratin e hekës. Miteve të shenjta kimerike të mrekullive të krijimit të njeriut i shtohet në këtë roman edhe një variant tjetër: miti i krijimit nga libri.

(Intervista botohet me shkurtime. Linkun origjinal dhe të plotë e gjeni në ***https://exlibris.al)***

reportazh

Bulqiza, “bukuroshja e fjetur”



Nga **SAMI CURRI** / Bulqiza ime

Një masë kritike prej 47 xhupash fosforeshentë kishin pushtuar trotuarin pranë RTSH-së. Të ishe pjesë e masës qeshje dhe mendoje eskursionet me shkollën, të ishe i jashtëm i merrje të gjithë për të marrë. Plot migrantë malesh, veshur ngjyra ngjyra, kundra borës dhe shiut që nuk po shkonin në Valbonë, as në Curraj apo në Lurë, po shkonim në Bulqizë. Ku do të dilte kjo masë kritike askush nuk mund ta dinte që pa gdhirë. Ishim gati për të filluar aventurën që gjithsecili e kishte ëndërruar sipas qejfit të tij.

47 veta, 3 munguar, 3 furgona, në orën 06:00 u nisëm për malet e Bulqizës.

Për të vajtur në Bulqizë rruga dikur kalonte nga Shkopeti dhe donte 4.30 – 5 orë. Për këtë arsye shumë pak njerëz kanë dëgjuar për Bulqizën turistike, por më shumë për historitë e dhimbshme të minatorëve në galeritë e minierave.

Sot rruga kalon përmes debateve të Rrugës së Arbërit dhe mbrrin në 2 orë. Një rrugë strategjike e premtuar në 30 vite, filloi me tjetërsimin e monumentit natyror “kanionet e Brrarit”, vazhdoi me erozionin, lumin e gërryer, ngjitet në 1000 metra si dhi mali dhe zbret në Klos. Kur nuk je në timon, ke luksin te besh debat.

Fakt është se në një vepër madhore dy anët e medaljes, janë lehtësisht të dukshme. Një anë e medaljes ishte se pa rrugën e re, ne nuk do e merrnim dot nismën e bukur për të bërë një mal në Bulqizë. Për zhvillimin turistik të krahinës së Bulqizës dhe Dibrës alternativa më e mirë që shkurton plot 100 km është rruga e arbrit. Ana tjetër e medaljes ishte vlerësimi i drejtë i shoferit tonë :“30 vite shofer, rrugë më të rrezikshme se kjo nuk kam parë ”. Turizmi i stresit në këtë rrugë ecën.

Në Klos rrëmuja e orës 7 ishte kryesisht te pilafi, kosi qe vonohej dhe aq. Duke ditur se kishim majë per herë të parë, Niku me Janin, dhe pse kishin hapur pjesë të madhe të shtegut kishin dyshimet e zakonshme te një maje të parë. Gjëja më e mirë ishte të haje shpejtë dhe ti fusje dhe një orë gjumë para se të mbërrinim në Bulqizë.

***

E pasur me shumë miniera dhe minerale, Bulqiza ishte një nga qytetet më të pasura të Shqipërisë. Bashkia e Bulqizës administronte së bashku me komunitetin pjesë të pasurive minerare dhe kjo ndihej në të gjithë infrastrukturën e zonës. Komuniteti këtu jetonte në begati dhe mirëqënie. Rrugët e shtruara ngado, transporti modern, treni që lëvizte mineralet, i shërben dhe njerëzve. Të gjitha këto e bënin Bulqizën të arritshme lehtë dhe shpejtë. Mes këtyre pasurive dhe bukurive natyrore, të jetoje në Bulqizë duhet të ishe me fat… por një gropë shkundte furgonin dhe ndërpriste çdo ëndërr.

Kishim arritur në Bulqizën tjetër.

Bulqiza ka dy qytete, një të vjetër dhe një të ri. Në mes i ndan rruga që shkon në Peshkopi. Qyteti njihet për padrejtësinë shoqërore, për vërfërinë dhe përjashtimin e komunitetit nga pasuritë natyrore.... Por “bukuroshja e fjetur” veç mineraleve, fsheh dhe 12 liqene akullnajore, disa përrenj kilometrikë, male madhështore, lugina të pashkelura, ujëvara si kartolina, kala e gura historikë, fushëbeteja, monumente të natyrës, dhe mbi të gjitha fsheh njerëz të mënçur dhe punëtorë.

Ora 08:40 arritëm në Fushë-Bulqizë. Të shihje karvanin e gjatë në rresht për një, të mbushte me ndjesi gëzimi. Dukeshin si zogj shtegtarë që po hidhnin fole në malet e Bulqizës. Ne ishim një masë kritike ku i dihej deri në fund çndodhte. I veshëm çizmet dhe rrobat e borës në kohë rekord dhe u nisëm menjëherë.

Nëse do të ishim një tren, Fisniku ishte lokomotiva, i shoqëruar nga një grup prej 5-6 malësorësh, jo për nga origjina e vendlindjes sesa për nga forca e maleve. Vagonat janë të larmishëm me shtegtarë, aventurierë, familjarë, profesionistë të të gjitha fushave, natyrëdashës, fotografë, biologë dhe cfare nuk ka. Kur flitet për maja të reja treni është i gjatë. Në fund te vagoni i mallrave kishim ngelur unë me Janin që diskutonim për Skavicën, turizmi apo HEC-i. Do ti ngjiteshim një lugine për 3 orë, kishim kohë ta zgjidhnim dhe këtë punë.

LUGINA ËSHTË RRUGA MË E BUKUR E NATYRËS

Luginat janë bashkime malesh, ku në mes kalon një përrua ose lumë. Aty ku bashkohen të dy anët e malit japin më të mirën. Gurë ciklopikë si dhuratë për njëri tjetrin, fara pemësh që era I çon nga një anë në anën tjetër deri te rrezet e diellit që shkëmbejnë përmes reflektimit. Aty në mes lugine nuk ka kufij as ndarje sesa bashkim. Një bashkëjetesë natyrale perfekte. Përroi që rrjedh në mes është produkt i disa maleve por lugina kujdeset që përroi të kalojë çdo grimcë akulli dhe uji, që buron nga malet e tjera dhe të vetat. Këto grimca jete shpërndahen si ushqim për tokën, si energji për njeriun, dhe kthehen sërish si flokë borë ne dimër, të reja, unike, çdo herë.

Ne marshuma për 3 orë mes lugines duke kaluar sa nga një anë e përroit në tjetrën. Muzika e përroit na shoqëroi përmes një dekori stalaktikesh, disa gurësh ciklopikë, një pyll I bukur armeni, dhe efekte speciale të borës që binte nga pemët. Dielli shndrrinte sa e linte mali. Maja nga poshtë luginës nuk dukej, por Jani me Nikun kishin qenë një ditë më parë dhe e kishin planin shumë të mirë. Do udhëtonim deri në 3 për në majë , pastaj arrinim nuk arrinim majën fillonte zbritja mos rrezikonim në errësirë një grup aq I madh. Më shumë se 1/3 e shtegut ishte hapur një ditë më parë, na ngelej të hapnim vetëm rreth 2/3 për tiu afruar një prej majave cilado të ishte në atë pikë.

Gjatë rrugës, Jani e kishte vlerësuar mundësinë e mosarritjes në majë, por ne jemi shumë , jemi të forte, do arrijmë, ishin përgjigja ime në cdo kohë. Një moment i mora leje Janit të dilja të ndihmoja para, dhe ashtu bëra. Nuk do ta harroj ndonjëherë mundimin me këmbë dhe me duar për të hapur qoftë dhe 5-6 metra rrugë. Një përpjekje fizike, deri në kacafytje me borën, që të këputste në pak minuta. 4-5 çuna në malore ndrroheshim çdo 10 metra pastaj kur dolëm në kurriz të malit çdo 20-30 metra. Të hapje shtegun në gjysëm metri borë, ishte një punë e vërtetë marinsash. Duhej forcë, eksperiencë, intuitë të gjesh shtegun natyror, një punë 24/24 orë.

Me të dalë nga lugina bora bëhej më e lartë , më e thellë, malorja më e fortë. Po dhe era këndonte më lartë, dielli fshihej më mirë, majat zhdukeshin më thellë në mjegull. Vetëm karvani i ngjyrave bëhej më I theksuar. Kishim marshuar 4 orë, majat ishin ende larg. Për dy orë dukej e pamundur të arrinim Majën e Muçekut , por mjaftonte për një nga majat e tjera, 150 më poshtë. Rrëzë të 3 majave të dukshme dhe 1 të padukshme nga mjegulla, diskutuam që zgjedhja për në majë të jetë me dëshirë. Një nga ato momentet që nëse do ishe vetëm do hiqje dorë menjëherë. Kur je me një grup fantastik, energjik, sfidues, që nuk pret asgjë të lehtë para, buzëqesh me pamundësitë. Pa zhurmë kaloi dhe paralajmërimi se në zbritje mund të na zinte nata.. Kishim hapur qindra hapa shteg në gjysëm metri borë, nuk do e linim për 200 metra ngjitje.



PELEGRINAZHI VENDOSI TË RREZIKONTE

Gjurmët e një arushi/e që kishte kaluar paradite ishte shenja për të vazhduar. Sikur të vinte nga maja e Mucekut do na ndihmonte dhe më shumë, por gjurmët ndaheshin për nga maja tjetër. Metrat e fundit ishin më të vështirat për tu carë nga pararoja.

Arritëm 2000 metra majën tonë pa emër, pas 6 orësh marshim. Ultësirë e Bulqizës, Korabi, Dibra, male të egra shfaqeshin përtej mjegullës. Në të djathtë ishte ende maja e Mucekut për zbuluar. Mundësia e vetme të ngjiteshe ato 200 metra ishte të hapje mjegullën, të fikje erën, të shkrije borën. Nga aty në një ditë pranvere mund të sodisje liqenin e dhive , liqenet e Kacnisë, Malet e Lurës , Dejës, deri në Mat. Kjo ishte një ftesë për një ekspeditë të dytë dhe për të fjetur në Bulqizë.

Si mbas provimi me një nëntë të merituar të gjithë po gëzonim me trokitje duarsh dhe përqafime. Në majë koha ka ritëm tjetër. Ja ta bëj një fota me këtë pemën, ja ta falenderoj pak këtë malin, prit të kap pak këtë kreshtën, shi sa bukur duket shtegu, deri sa pa e kuptuar të dridhen buzët , të kërcasin dhëmbët nga i ftohti,dhe sheh orën 3 mbasdite. Duhet të vraponim për në luginë .

Bukuroshja e fjetur do vazhdonte të zgjonte dëshirën e qindra vizitorëve të tjerë. Të bukrat e fshehta të Bulqizës po zgjoheshin…

Për shumë arsye zbritja ishte shumë herë më e lehtë , mjafton të ndiqje shtegun nga u ngjitëm. Problem ishte koha, prandaj të gjithë nxitonim. Grupin e fundit prej 7 vetësh perëndimi na kapi në mes të luginës, në një peizazh romantik, me qiell rozë, rrethuar nga kurora resh në maja, poshtë armenëve, anës përroit, në një ecejake për të mos rrëshkitur në peizazh. Një anëtar i grupit ndaloi disa herë, një tjetër kishte pak dhimbje ne kembe, të gjitha arsye për ta marrë shtruar dhe shijuar bukurinë deri në errësirë. Hëna ishte e plotë, dritat nuk na mungonin. Të fundit me Janin vazhdonim pas 9 orësh marshim debatin për luginën e Drinit apo hidrocentralin e Skavicës.

Kishim kaluar vetëm disa orë në malet e Bulqizës, por ishte një udhëtim i rrallë dhe i mrekullueshëm. Bulqiza modeste na kishte ftuar pa ndonjë pritshmëri të madhe, por malet e saj, luginat, peizazhet, ujërat, vetë historia e saj, të bëjnë për vete edhe kur flejnë.

cyan magenta yelloë black

profil

Petrit Ndreu i Dardhës që nga Amerika i thotë "Jo Skavicës!"

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**



Unë bëra detyrën që i takon çdo dibrani që i sheh ëndrrat në lëndinat e bukura te liqenet e Lurës, bregut te Drinit të kaltër dhe ngjitet deri ne majat e larta te Korabit

Ai i tha "Jo Skavicës".

Publikisht, larg e larg tej oqeanit Atlantik.

Drejtpërdrejt i mësova vetëm mbiemrin. Në kërkim i mësova edhe emrin, edhe vendlindjen, edhe fisin, edhe familjen. Dikush më solli fotografinë e tij me mikrofon në dorë tek kërkonte të dinte për atë që tash është fjalë e ditës, fjalë e artikuluar jo thjesht me zë (sepse ka 10-12 vjet që rrotullohet në zgavrën e gojës) por me prerje shiriti, me buldozerë që shtyjnë shkëmbej e me sonda që kapin thellësi, me fjalën e një ministreje ndërtimi që llaf të parë nxjerr nga goja "ndërtojmë Skavicën që të mos mbytet Shkodra" dhe të ambasadores së fuqisë më të madhe të botës që i gëzohet ndërtimit të një dige që në vendin e vet do ta quanin herezi, shkatërrim të natyrës.

E pyeti ish kryeministrin Berisha për Skavicën, për ndërtimin e saj dhe mori po të njëjtën përgjigje si 10-12 vjet më parë kur deklaronte:

"Skavica do të jetë në2 vitet që vijnë projekti kryesor i punëve publike në Republikën e Shqipërisë"

"Shqipëria i ka të gjitha potencialet për të ndërtuar këtë vepër të mrekullueshme."

"Ne duhet të ndërtojmë Skavicën. Kaskada është pasuri e madhe. Skavica është nëna e të gjitha digave nën të."

"Skavica është një nga ngushticat më të ngushta në vendin ku presupozohet se do të ndërtohet diga, por edhe me shpatullat shkëmbore

më të forta. Do të prodhohet më shumë se një miliard kilovat orë energji".

"Qeveria ka faktuar se në Shqipëri ekzistojnë mundësitë e ndërtimit të veprave botërore". (Citimet janë marrë nga libri "PO DIBRËS! – JO SKAVICËS" -Tiranë 2010

Në përgjigjen drejtpërdrejt Berisha ishte për "një Skavicë të vogël", një Skavicë që të mos mbyste tokat në Maqedoni...

Ish kryeministri Berisha i vitit 2021 nuk ndryshonte nga kryeministri i vitit 2010, nuk ndryshonte nga kryeministri i Republikës së Shqipërisë i vitit 2021, Edi Rama. Të dy, si pendë në zgjedhë një parmendë tërheqin, parmendën për ta mbysë Dibrën, për ta qit fare, për ta shuar e zhdukur nga faqja e dheut.

Po kush është Petrit Ndreu?

E pyeta...

Mu përgjigj...

Emri im është Petrit Hakik Ndreu.

Lindur ne Zall-Dardhe më 5/9/1977, në një familje patriotike të Dardhës.

Në vitet 92-96 mbarova gjimnazin Riza Doda në Zall-Dardhë.

Për arsye emigrimi, nuk vazhdova të ndjek shkollën e lartë.

Kam qëndruar për 5 vite në Selanik të Greqisë.Më pas u zhvendosa në Tiranë.

Në Tiranë nuk qëndrova shumë kohë.U angazhova me strukturat e partisë demokratike në zonën e 21-shit.

Në 2005 mu dha mundësia të prek ëndrrën amerikane, që gjithkush mund ta ëndërronte. Fitovalotarinë amerikane.Këtu jetoj aktualisht me familjen time.

Jam sipërmarrës nëfushën e ndërtimit, kam një kompani modeste.

Me datë 12/12/21 na u dha mundësia te bashkëbisedonim me Prof.Dr.Sali Berisha.

Në sallë ishim një grup dibranësh, një ndër këtaështëMaks Puci nga Venishti,i cili tradhtoi komunizmin ne 1989 duke u larguar nga mali i Korabit.Ai është shume aktiv përçështjen e Skavicës.

E pyeta Berishën,sepse si dibran e kam obligim që te ngremë problemet ekonomike tëDibrës,ne këtë rast çështjen"Stop Skavica".

Me përgjigjen e Berishës nuk u impresionova.

Nuk mund te replikoja dot përarsyeje kohe .



NëDardhë kam 3 familje Ndreu aktualisht,por kemi projekte tëndërtojmështëpi pushimi dhe për te jetuar.

Skavica na mbyt te gjitha fushat dhe shtëpitë nëZall-Dardhë, dhe te gjitha kujtimet e atij vendi(do të jetë shumë e trishtë).

Do vazhdojmëbetejën.

Faleminderit përvlerësimin si hero tëbëra nga komentuesit në rrjetet sociale,por unëbëradetyrën që i takon çdo dibraniqë i sheh ëndrrat nëlëndinat e bukura nga liqenet e Lurës, bregut te Drinit të kaltër dhe ngjiten deri ne majat e larta te Korabit.

Zoti e bekoftëDibrën!

Zoti e bekoftëShqipërinë!

Zoti e bekoftëAmerikën!

Me respekt

Petrit Ndreu

I kërkova disa fotografi...

Ai më solli Dardhën, Zallin dhe kodrat e bukura, shkollën ku mbaroi gjimnazin, Drinit në dëshirën e tij që ai të rrjedhë siç ka rrjedhë në mijëvjeçarë, herë i qetë e herë me tallaze, pa prita e diga...

Kishte mall. Shumë mall e dashuri...

Athinë, dhjetor 2021

Pajtohu në gazetën **RRUGA E ARBËRIT**
pranë çdo filiali të **POSTËS SHQIPTARE**
në të gjithë Shqipërinë.
Një pajtim vjetor kushton 600 lekë.

Mbështetja financiare përmes pajtimeve është mënyra e vetme dhe më e mira për një gazetë të lirë në shërbim të publikut.

POSTA SHQIPTARE

PayPal
rrugaearberit@gmail.com

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank, Rruga e Arberit. Nr. llog. në lekë: 0010036640. IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640
PAJTIMET TUAJA JANË E VETMJA MBËSHTETJE PËR TË RUAJTUR LIRINË DHE VAZHDIMËSINË E GAZETËS!

BIG market

Gazetën **Rruga e Arbërit** mund ta merrni pranë **Big Market** në **Peshkopi**, **Maqellarë** dhe **Laprakë** (Blloku Gintash)

Rruga e Arbërit nr. 184

histori

Marrë nga libri "HISTORIA E DIBRËS" - Që nga lashtësia deri në mars 1939 i prof. dr. Kristo Frashëri. ISBN: 978-99956-04-82-0, Botimet M&B, Tiranë 2012

Dibra pas Pavarësisë Kombëtare (1912-1918)

Nga akademik **KRISTO FRASHËRI**

(Vijon nga numri i kaluar)

Qeveria e Vlorës dërgoi me të shpejtë, aq sa dispononte, disa ndihma financiare në favor të muhaxhirëve, por këto qenë të pamjaftueshme. Të dëshpëruar në kulm nga braktisja e vendlindjes dhe nga hyrja e dimrit, shumë familje muhaxhirësh vendosën të ktheheshin në vatrat e tyre.

Aty nga fundi i vitit 1913, disa qindra gollobordas të grumbulluar në Elbasan, morën rrugën e kthimit. Por pararoja e tyre, nja 30 vetë, u kap nga serbët te Qafa e Klenjës. Të gjithë pjesëtarët e pararojës u pushkatuan barbarisht në vend, me përjashtim të njërit që shpëtoi mes plumbash dhe së bashku me vargun që vinte pas pararojës, u kthyen përsëri në Elbasan. Dimri, të cilin muhaxhirët e kaluan me vështirësi të jashtëzakonshme, u rrëmbeu atyre qindra viktima të tjera të shkaktuar nga uria dhe nga sëmundjet.

Në marsin e vitit 1914, kur princi Vid erdhi në Durrës, Fuqitë e Mëdha ia përsëritën Serbisë kërkesën për të larguar ushtritë e saj nga viset që Konferenca e Ambasadorëve ia kishte lënë Shqipërisë. Beogradi ushtritë e veta i largoi vetëm nga Dibra e Poshtme, kurse tërheqjen e tyre nga viset që nuk i takonin në Dibrën e Epërme, e zvarriti me pretekstin se këtu komisioni ndërkombëtar ende nuk i kishte caktuar piramidat e kufirit shqiptaro-serb. Madje, për t'i krijuar shtetit shqiptar vështirësi në këto anë, qeveritarët serbë vunë në qarkullim aventurierin e njohur xhonturk, Arif Hiqmetin, i cili me të hollat e financuara prej Beogradit, u orvat të kurdiste në Dibrën e Epërme një lëvizje "myslimane" në paraqitje antividiste, në thelb antishqiptare. Veprimtaria antikombëtare që zhvilloi Arif Hiqmeti nga fshati Reshan, afër Shehrit, ku ai e vendosi selinë e vet, shkaktoi një reagim të fortë te patriotët dibranë, të cilët u ngritën kundër agjentit serb, duke u bashkuar me qeverinë e Vidit.

Me riorganizimin administrativ që bëri qeveria e Vidit, Dibra mbeti përsëri prefekturë (sanxhak), me ndryshim se qendra e saj tani ishte në Peshkopi. Në krahasim me sanxhakun e mëparshëm të Dibrës, territoret e prefekturës shqiptare të Peshkopisë qenë më të pakta. Tani ajo nuk përfshinte më Dibrën e Madhe (qytetin e Shehrit), Fushën e Rehonikut, nahijen e Koxhaxhikut, një pjesë të Gollobordës dhe kazanë e Rekës me gjithsej 97 fshatra, të cilat mbetën jashtë Shqipërisë. Tani prefektura shqiptare e Dibrës ndahej jo në katër, por në tri nënprefektura (kaza) – nënprefekturat e Peshkopisë, Zerqanit dhe Matit me 144 fshatra, në të cilët, para shpërnguljes së shtatorit 1913, banonte afërsisht gjysma e popullsisë që kishte sanxhaku i mëparshëm i Dibrës me 241 fshatra. Me vendosjen e administratës shqiptare, muhaxhirët e viseve që i mbetën Shqipërisë filluan të ktheheshin në shtëpitë e tyre, kurse muhaxhirët e zonave të aneksuara nga Serbia, në pjesën dërrmuese qëndruan në Shqipëri.

Qeveria shqiptare e Durrësit emëroi prefekt në Peshkopi Isuf bej Dohoshishtin nga Dibra e Poshtme. Detyrat e tij urgjente ishin: mëkëmbja e administratës shqiptare në viset e çliruara dhe shtrirja e saj në trojet e pushtuara nga serbët që i takonin Shqipërisë. Detyra e dytë ishte mjaft delikate, sepse ushtritë serbe nxirrnin pretekste të ndryshme për ta vonuar largimin e tyre dhe vazhdimisht provokonin duke shkaktuar incidente kufitare. Me propozimin e patriotëve dibranë, që tani u grumbulluan në Peshkopi, barra e ruajtjes së qetësisë brenda trevës dhe e mbrojtjes së saj nga provokacionet serbe, iu ngarkua Elez Isufit, i cili për këtë qëllim formoi me të rinj vullnetarë një milici lokale shqiptare në emrin "Batalioni i Drinit". Milicia vullnetare dibrane qëndroi edhe pasi në fillim të shtatorit 1914, princi Vid me qeverinë e Durrësit u larguan nga Shqipëria.



Xhonturqit e Shqipërisë së Mesme ushtruan një presion të vazhdueshëm ndaj dibranëve për t'i bindur që të luftonin bashkërisht kundër Esat pashës. Por dibranët, të shqetësuar nga parullat turkomane të xhonturqve refuzuan gjithashtu, përveç disa fshatarëve të Gollobordës, që bashkëpunuan me ta. Dibranët qëndruan kështu "asnjanës" përballë të dyja palëve duke qeverisur vetveten në bazë të kanuneve vendase. Në përputhje me këtë qëndrim, në qershor të vitit 1915, dibranët nuk i lejuan ushtritë serbe të marshonin përmes territorit të tyre, për të shtypur kryengritjen e Shqipërisë së Mesme dhe për të ndihmuar Esat pashën e bllokuar në Durrës.

Ndërkohë, situata politike ndërkombëtare u ndërlikua në kulm. Që në fund të qershorit Austro-Hungaria i kishte shpallur luftë Serbisë, kurse në fillim të gushtit kishte shpërthyer Lufta e Parë Botërore. E preokupuar me frontin luftarak në veri, tani qeveria e Beogradit nuk donte të kishte telashe në jug. Arif Hiqmeti, i cili ishte diskreditуar si agjent serb dhe si i tillë kishte dështuar përfundimisht, nuk i vlente më Beogradit, aq më tepër kur tani që Turqia dukej se po rreshtohej në anën e Vjenës, parulla e tij për një princ "mysliman" në Shqipëri, i shërbente kryesisht Stambollit. Siç dihet, interesat që kishte qeveria serbe për të pasur një Shqipëri "Aleate", i shfrytëzoi Esad pashë Toptani, kundërshtar i politikës austriake dhe simpatizant i fuqive të Antantës, aleatët e mëdhenj të Serbisë. Për këtë qëllim, sapo mori vesh largimin e Vidit, ai u nis nga Franca dhe nëpërmjet Greqisë arriti në Nish, ku e siguroi kryeministrin Pashiç se me ndihmën financiare serbe ai do të formonte një qeveri shqiptare "mike" të Serbisë. Pashiçi i dha Esatit jo vetëm disa barrë me flori, por edhe mundësinë që të rekrutonte forca të armatosura në Dibrën e aneksuar, me të cilat ai do të vendoste pushtetin e vet në Shqipëri.

Esat pashë Toptani erdhi në Dibër më 24 shtator 1914. Sapo erdhi, ai i ftoi dibranët ta zbonin nga treva e tyre Arif Hiqmetin, i cili tashmë njihej si agjent serb dhe u deklaroi atyre për demagogji se qëllimi i tij ishte të rimëkëmbte Shqipërinë e pavarur, pa princ të huaj, as evropian, as turk, por me një prijës shqiptar në krye të shtetit. Nga Shehri pashai toptanas shkoi në Peshkopi, ku më 26 shtator 1914, në një takim që pati me parinë e maleve, trajtoi të njëjtën platformë. Patriotët demokratë dibranë, të cilët e njihnin fytyrën e vërtetë të Esat pashës, u përpoqën ta pengonin veprimtarinë e tij. Madje, ditën që ai ndodhej në Peshkopi, ata organizuan kundër tij një atentat, i cili dështoi për shkak të lëvizjeve shumë dinake që bënte pashai. Në përgjithësi qytetarët e Shehrit së bashku me shumicën e malësorëve nuk u pajtuan me Esatin. Por në disa vise malësorët e njihnin ndryshe pashanë toptanas. E njihnin si komandant të divizionit, nën urdhrat e të cilit disa prej tyre kishin luftuar më 1913 në Shkodër kundër ushtrive serbo-malazeze. Po ashtu e njihnin si kundërshtar të hapur të princ Vidit, të cilin ata asnjëherë nuk e kishin simpatizuar. Kjo rrethanë i dha tij mundësi të rekrutonte nja dymijë vetë, të cilët duke kujtuar se i shërbenin atdheut dhe duke pasur nevojë për rrogën që ai u premtoi, e ndihmuan Esat pashën të vinte në Durrës dhe të shpallte më 2 tetor 1914, formimin e qeverisë shqiptare nën kryesinë e vet. Megjithatë, shumica e dibranëve mbetën kundërshtarë të tij. Për këtë arsye, ai nuk e shtriu dot autoritetin e vet në trevën e Dibrës. Madje, sapo filluan të dilnin në shesh lidhjet e Esatit me qeverinë serbe, shumica e malësorëve të rekrutuar prej tij, e braktisën njëri pas tjetrit.

Në të njëjtën kohë, xhonturqit e Shqipërisë së Mesme ushtruan një presion të vazhdueshëm ndaj dibranëve për t'i bindur që të luftonin bashkërisht kundër Esat pashës. Por dibranët, të shqetësuar nga parullat turkomane të xhonturqve refuzuan gjithashtu përveç disa fshatarëve të Gollobordës, që bashkëpunuan me ta. Dibranët qëndruan kështu "asnjanës" përballë të dyja palëve duke qeverisur vetveten në bazë të kanuneve vendase. Në përputhje me këtë qëndrim, në qershor të vitit 1915, dibranët nuk i lejuan ushtritë serbe të marshonin përmes territorit të tyre, për të shtypur kryengritjen e Shqipërisë së Mesme dhe për të ndihmuar Esat pashën e bllokuar në Durrës. Në fakt, serbët marshuan nga ana e Qafë-Thanës. Sapo shtypën kryengritjen, iu turrën në befasi Dibrës së Epërme dhe e thyen pa ndonjë vështirësi rezistencën spontane lokale.

Ushtritë serbe u larguan nga viset e Dibrës në janar të vitit 1916, kur të thyer nga ofensiva austro-hungare, u detyruan të braktisnin atdheun e tyre dhe të tërhiqeshin përmes Shqipërisë për të kaluar në Korfuz dhe gjetkë. Në Dibër arritën menjëherë ushtritë bullgare, por këto nuk qëndruan shumë, sepse në mars 1916, nën presionin e Vjenës u tërhoqën. Vendin e tyre e zunë ushtritë austro-hungare, të cilat qëndruan këtu deri në tetor të vitit 1918.

Austriakët u paraqitën tek dibranët si përkrahësit e Shqipërisë në luftën e tyre kundër serbëve. Me këtë parullë ata u përpoqën të formonin me malësorë reparte "vullnetarësh", të cilat t'i hidhnin në luftë kundër "aleatëve" të serbëve – ushtrive italiane që ndodheshin në Shqipërinë e Jugut. Në shërbim të këtij synimi, autoritetet austriake u dhanë krerëve shpërblime dhe u premtuan subvencione në përpjesëtim me forcat që do të rekrutonin. Kujdes të veçantë treguan për Elez Isufin, të cilin e dekoruan si "luftëtar të shquar kundër serbëve" dhe e ftuan të merrte pjesë si përfaqësues i Dibrës në delegacionin shqiptar që do të vinte në Vjenë, në shkurt të vitit 1917, për të përshëndetur perandorin austriak me rastin e ditëlindjes. Krerët e Dibrës nuk i refuzuan shpërblimet. Elez Isufi shkoi si pjesëtar i delegacionit në Vjenë. Por Vjena, nuk rekrutoi dot forca malësore për interesat e Perandorisë Austro-Hungareze.

Në fund të Luftës së Parë Botërore, në Dibër erdhën përsëri ushtritë serbe (tetor 1918). Erdhën si pjesëtarë të Antantës, bllokut që kishte fituar luftën. Me vete kishin Traktatin e Londrës, i cili ishte nënshkruar në mënyrë të fshehtë më 26 prill 1915 midis Anglisë, Francës, Rusisë dhe Italisë. Në bazë të traktatit, në rast se luftën do ta fitonte Antanta, Jugosllavia dhe Greqia do të shpërbleheshin me aneksimin, e para të viseve veriore, e dyta të viseve jugore të Shqipërisë. Italia do të aneksonte Vlorën me hinterlandin e saj, së bashku me ishullin e Sazanit, kurse viset e Shqipërisë Qendrore do të formonin një shtet mysliman nën protektoratin e Italisë. Në nenin 7 të traktatit thuhej se pjesët veriore dhe jugore të Shqipërisë, do të pjesëtoheshin midis Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë në atë masë sa do ta shihnin të arsyeshme fuqitë e Antantës. Pra, në bazë të Traktatit të Londrës, Jugosllavia përfitonte më tepër nga ç'kishte pretenduar me anën e "vijës strategjike" – pra, siguronte aneksimin e pjesës veriore të Shqipërisë. Së bashku me serbët erdhën në Dibër nga Selaniku edhe forcat e armatosura të Esat pashë Toptanit (disa qindra mercenarë), të cilat gjatë luftës botërore kishin luftuar për llogari të Antantës. Duke përfituar nga përçarja e thellë që kishte plasur në radhët e parisë, në fund të tetorit ushtritë serbe shtinë në dorë Peshkopinë. Me ndihmën e Taf Kaziut dhe të disa krerëve të tjerë, gjatë nëntorit kaluan Drinin në pjesën e Dibrës së Epërme, duke u shtrirë deri në Qafën e Buallit dhe në Qafën e Murrës. Masa dërrmuese e banorëve dhe shumica e parisë dibrane nuk pranuan të afroheshin as me pushtuesit serbë, as me forcat esadiste, të cilat për më tepër filluan të pakësoheshin nga largimi i mercenarëve jo vendës për në viset e tyre.

(vijon)

botime

Pas botimit të librit vjen edhe nisma e dy organizatave kombëtare të veteranëve

Një shkollë me emrin e Heroit të Paqes **Klodian Tanushi**

Nga **Halil RAMA**

Kemi dëgjuar për monografi që fëmijët ua kanë kushtuar prindërve të tyre të njohur në histori për akte patriotike e heriozimi. Kemi lexuar me interes monografi për heronj e dëshmorë të atdheut, të shkruara nga autorë të ndryshëm, për vetë misionin e tyre historik të edukimit patrioikt të brezave. Por me heroin e paqes Kodian Tanushi, ndodh e kundërta. Është babai i tij, Basriu, autor i veprës monumentale (me 358 faqe) "Klodian Tanushi, Heroi i Paqes", botim shumë cilësor nga Botimet M&B.

Pikërisht vlerat e kësaj vepre janë motivi i propozimit që dy organizatat e veteranëve: Komiteti Kombëtar i Org.Veteranëve të LANÇ dhe OBVL i kanë bërë Këshillit Bashkiak të Tiranës për emërtimin e shkollës së re te "Fresku" (Lagje 12) me emrin e dëshmorit Klodin tanushi.

Është kjo një vepër që përjetëson Heroin që përfaqësoi vlerat më të larta të ushtarakut shqiptar, jashtë vendit të tij, në kuadër të NATO-s, që bëri sakrificën sublime, duke dhënë jetën e tij të re në krye të detyrës në Letoni, si komandant i Forcave Paqeruajtëse Shqiptare.

Dy vjet më parë, Kryeministri Edi Rama, solli në vëmendje të opinionit publik kujdesin që u tregua nga ish-ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka për dy djemtë e major Klodian Tanushit, rënë në krye të detyrës më 10 maj 2019 në Letoni.

Nëse dy vjet më parë kur shoqëroi për në shkollë dy djemtë e Heroit të Paqes, ditën e parë të fillim vitit të ri shkollor 2019-2020 Xhaçka u shpreh se "familja e madhe e Forcave të Armatosura i gjendet pranë çdo efektivi të saj, jo vetëm me fjalë por edhe me vepra për atë çka kanë më të shtrenjtë në jetë", tashmë është koha për ta konkretizuar këtë premtim. Dhe kjo arrihet fare mirë qoftë dhe duke mbështetur propozimin e organizatave të veteranëve për ta përjetësuar ish-ushtarakun e vijës së parë Klodian Tanushi në shkollën ku do të mësojnë fëmijët e tij. Kështu do tía lehtësojnë sadopak dhimbjen prindërve dhe familjes së tij që jetojnë pikërish në zonën e Freskut ku po ndërtohet kjo shkollë.

NË LETONI, MEMORIAL PËR KLODIAN TANUSHIN DHE ZARIFE HASANAJN

Nësë në kampin e NATOS në Letoni është vendosur një memorial për Klodian Tanushin dhe Zarife Hasanajn, të cilët humbën jetën pas shpërthimit në bazën e NATO-s në Letoni, vendosja e emrit të Klodianit shkollës së re që po ndërtohet në zonën ku jeton familja e tij, do të ishte një vendim historik i Këshillit Bashkiak të kryeqytetit. Nëse është mirëpritur nga opinioni publik emërtimi i i shkollës së Baldushkut me emrin e Feti Voglit dhe i një kopshti në Paskuqan me emrin e Zarife Hasanajt, e enjeta procedurë duhet ndjekur edhe për përjetësimin e emrit të Klodian Tanushit.

Në librin e babait të tij gjen mesazhe vlerësuese të personaliteve ndërkombëtare e vendase që e vendosin Klodian në panteonin e vlerave të kombit. Mjafton të perifrazojmë qoftë dhe Ministrin e Mbrojtjes të Letonisë Artis Pabriks se "Letonia është shumë mirënjohëse për aleatët tanë nga Shqipëria, për kontributin e tyre në praninë e zgjeruar të NATO-s në grupin e betejës".

Nëse në ditën kombëtare të dëshmorëve në Letoni, përkujtohen dëshmorët më të rinj të Shqipërisë, major Klodian Tanushi dhe nëntetare Zarife Hasanaj, s'ka dyshim që në vendlindjen e tyre ata duhen pëkujtuar më me madhështi. Ndaj dhe emërtimi i një shkolle me emrin e Klodianit do të ishte vendimi i duhur.

Jeta e Klodianit, Zarifes dhe shumë të tjerëve që shërbyen dhe ranë heroikisht në në misionet paqeruajtëse flet për dinjitetin e gjakut që nuk bëhet ujë, për shembullin e krijuar që nga marrja e qumështit dhe këshillave të para të nënës e babait në djep, deri në përfshirjen në këtë familje të madhe të Forcave të Armatosura, e cila është e përkushtuar për të mbrojtur bashkësinë e madhe të njerëzve të këtij vendi dhe të Aleancës. Ata na tregojnë se paqja ka një çmim.

Dhe siç shkruan Kamber Faruku në parathënien e këtij libri: "Lapidari përkujtimor i djalit flokëverdhë dibran,majorit të NATO-s Klodian Tanushi, atje në Letoninë e largët, është

Klodiani ishte model qytetarie, ushtarak shembullor, familjar i përkryer. Ndaj, dhjetëra janë vlerësimet e nderimet institucionale, që i janë bërë major Klodian Tanushit, për së gjalli dhe pas vdekjes

një simbol i miqësisë mes popujve, që bën krenar jo vetëm familjen e Klodianit, nënë Lumen dhe babë Basriun, por çdo shqiptar. Ai lapidar I heroit të NATO-s është në sintoni me trimërinë dhe humanizmin shekullor të popullit shqiptar, i cili është ndezur si qiri edhe për lirinë e të tjerëve. Mijëra njerëz, në shekuj, do të qëndrojnë të heshtur dhe kuriozë para asaj pllake përkujtimore, si në një vend të shenjtë. Do lexojnë aty, do pyesin, do mësojnë dhe do nderojnë këtë luftëtar të përjetshëm të paqes". Madje sipas redaktorit Faruku, ky është filli i kuq, i cili përshkon këtë libër, të shkruar me ndjenjë prindërore nga i nderuari dhe i papërkuluri me një karakter burrëror Basri Tanushi, shkëlqyer i Republikës së Shqipërisë.

KONTRIBUTI NË MISIONET NDËRKOMBËTARE TË PAQES

Nuk ishte detyra e parë e Major Klodianit në misione ndërkombëtare paqeruajtëse. Kontributi i tij në këtë fushë është i shquar dhe i shtrirë në kohë. Pjesëmarrja e tij në misione ndërkombëtare është, si më poshtë:

Më 16 shtator 2012 deri më 6 mars 2013 ka marrë pjesë në misionin "Althea" në Bosnje-Hercegovinë, me detyrë komandant kontingjenti.

Më 19 qershor 2017 deri më 15 dhjetor 12017 ka marrë pjesë në misionin e NATO në Letoni, me detyrë komandant kontingjenti. Klodian Tanushi - Heroi i Paqes 283

Më 20 dhjetor 2018 deri më 10 maj 2019 ka marrë pjesë në misionin e NATO në Letoni, me detyrë komandant kontingjenti dhe përfaqësues i lartë ushtarak.

Më 6 maj 2019, gjatë një operacioni çminimi, ndodhi një incident i rëndë, ku mbetet e vdekur në vend nëntetarja Zarife Hasani dhe u plagos major Klodian Tanushi dhe nëntetar Julian Kapaj, nga shpërthimi i një mine. Pas katër ditësh, më 10 maj 2019, ndërron jetë edhe major Klodian Tanushi, duke mos iu bërë ballë plagëve të marra, me gjithë kujdesin e veçantë të mjekëve. Më 15 maj 2019, trupi i tij i pajetë u kthye në atdhe.

Më 16 maj u bë varrimi i dëshmorit Klodian Tanushi te Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut. Kur Klodiani kreu aktiv sublim të rënies në krye të detyrës ushtarake, ishte më pak se 39 vjeç, sepse ai kishte lindur më 31.10.1980. Major Klodiani u largua si burrat prej njerëzve të tij të dashur, prej miqve dhe shoqërisë, prej Forcave të Armatosura, kur ishte në më të mirën ditë, në më të mirën moshë, pikërisht atëherë, kur ai mund t'u jepte akoma më shumë kontribute familjes së tij të nderuar, shoqërisë dhe Forcave të Armatosura.

DHJETRA VLERËSIME E NDERIME INSTITUCIONALE PËR KLODIN TANUSHIN

Në librin "Heroi i heshtur i paqes", referuar publicistit dhe shkrimtarit Fatos Daci, autori shkruan se "Klodiani ishte model qytetarie, ushtarak shembullor, familjar i përkryer.

KËRKOHET GAZETAR

Kërkohen një gazetar. Detyra kryesore është të shkruajë dhe raportojë për ngjarje që ndodhin në qarkun e Dibrës.
Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë.
Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi.
Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të tregojë pavarësi politike në shkrimet për gazetën.
Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.
Tel. **069 20 68 603** E-mail. **rrugaearberit@gmail.com**



Ndaj, dhjetëra janë vlerësimet e nderimet institucionale, që i janë bërë major Klodian Tanushit, për së gjalli dhe pas vdekjes" Kjo sipas tij për faktion se mMajor Klodian Tanushi, pas rënies heroike në krye të detyrës, me vendimin nr.786, datë 13.5.2019, të Komisionit të Posaçëm Qendror të Statusit "Dëshmor i Atdheut", u shpall "Dëshmor i Atdheut".

Me urdhrin nr.706, datë 31.5.2019, të Ministrit të Mbrojtjes, i jepet "Medalja e Nderit"ndërsa me urdhrin nr.554, datë 11.5.2019 të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, i jepet Medalja "Luftëtari".

Më 10 maj 2021, Presidenti i Republikës, Zoti Ilir Meta, me një ceremoni të posaçme solemne, dekoroi me "Dekorata e Artë e Shqiponjës" Dëshmorin, Major Klodian Tanushi (pas vdekjes).Kreu i shtetit vlerësoi kështu aktin sublim të Major Tanushi i cili lartësoi Shqipërinë dhe Forcat tona të Armatosura, si një anëtare e denjë e NATO-s, për t'u shndërruar, nëpërmjet profesionalizmit të tij të lartë dhe trimërisë së rrallë të dëshmuar, në një shembull të përhershëm frymëzimi për çdo shqiptar.

Gjatë karrierës së tij ushtarake qe vlerësuar: -Me Medaljen e "Karrierës" nga Komandanti i Forcës; -Medaljen e "Shërbimit" nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm; -Medalje "Shërbimi në Mision jashtë vendi"; -Medaljen "Për pjesëmarrje në shërbime ndërkombëtare" nga Ministri i Mbrojtjes; - Medaljen e "Mbështetjes" nga Komandanti i Komandës Mbështetëse.

Me vendimin nr.09, datë 23.12.2019, të Këshillit të Qarkut Dibër, Klodian Tanushi është shpallur "Qytetar Nderi i Qarkut Dibër". Këtyre vlerësimeve të rëndësishme iu shtohet dhe një vlerësim tjetër me shumë vlerë. Një vit më parë, një vlerësim e nderim të lartë i bëri djaloshit trim dibran, major Klodian Tanushit, edhe Këshilli Bashkiak i bashkisë së Dibrës, me kryetar z.Sokol Sava. Ky këshill, me vota unanime, me vendimin nr.60, datë 10.4.2020, vendosi që rruga nga kryqëzimin i fundit i Bulevardit me rrugën e Pollozhanit, deri te ish Shkolla Bujqësore (Karburanti) të emërtohet "Rruga Klodian Tanushi". Kësisoj, major Klodian Tanushi, "Dëshmor i Atdheut", do të jetë përditë e për çdo kohë në mesin e banorëve të këtij qyteti, në kujtesën dhe shpirtin e tyre.

Major Klodian Tanushi shpalosi trimëri, guxim, përkushtim e profesionalizëm në kryerjen e detyrave ushtarake, që i ishin ngarkuar, si dhe dha kontributin e tij të vyer në mbrojtje të vlerave të paqes dhe sigurisë, kudo në botë. Ai përfaqësoi e vlerat më të larta të ushtarakut shqiptar, jashtë vendit të tij, në kuadër të NATO-s, bëri sakrificën sublime, duke dhënë jetën e tij të re në krye të detyrës në Letoni, si komandant i Forcave Paqeruajtëse Shqiptare. Më parë, për gati njëzet vjet, major Klodiani kishte dhënë kontributin e tij të çmuar edhe për forcimin e modernizmin e Forcave tona të Armatosura, duke komanduar në nivele të ndryshme me shumë profesionalizëm dhe përkushtim atdhetar. Major Klodian Tanushi ishte një djalë i ri, që gdhendi emrin e tij me shkronja të arta në historinë e Shqipërisë, është dëshmori më i ri nga ushtarakët shqiptarë, që ra në krye të detyrës në mbrojtje të paqes dhe sigurisë në botë. Ishte një djalë i ri, me dashuri të madhe për jetën, për profesionin dhe për paqen, kudo në botë.

Që nga koha kur u ndërtua kjo kullë, gati dy shekuj më parë, vitet dhe koha kanë ecur. Kanë ndryshuar brezat, ka ndryshuar dhe kulla, por nuk kanë ndryshuar themelet e saj. Kanë ndryshuar njerëzit, pasardhësit dhe trashëgimtarët e kullës, kanë ndryshuar edhe miqtë e saj, por nuk ka ndryshuar tradita, bujaria dhe mikpritja e kullës së Xheladin Hysës.

Sofra e kullës së madhe në Lashkizë

Nga **SHAQIR ÇERPJA**



Në foto: Kulla e Xheladin Hysës në Lashkizë



Bashkëshortët Xheladin Hysa dhe Baftie Kaca - Hysa

Lashkiza është fshat i thellë malor i Dibrës. Ka terren të thyer malor, me brinja e shpatet të pjerrëta, rrethuar me kodra, maja dhe male. Ka pak tokë rrafshe dhe pak tokë arë të punueshme. Për këto arsye, por edhe për shkak të dimrit të ftohtë e mungesës së infrastrukturës, gjatë tri dekadave të fundit, popullsia e këtij fshati ka lëvizur, janë larguar nga ky fshat dhe janë vendosur në zona të ulta, në Tiranë, Durrës, etj. Lashkiza është shquar për patriotizëm, atdhedashuri dhe histori epike. Përkundër mundësive të pakta dhe të kufizuara për jetesë, banorët e Lashkizës janë shquar për zemërbardhë, mikpritje e bujari, siç ishte dhe është kulla, shpia dhe familja e Xheladin Hysës dhe pasardhësve të tij.

Ky fshat, fshati Lashkizë, e ka marrë këtë emër, shumë më heret se të popullohej e të banohej nga banorët e parë të saj. Tregojnë se shumë herët, kur akoma nuk ishte populluar, ky vend ishte pyll, ku dominonte lajthia, por edhe shkoza, lisa e shkurre të tjera. Në krye të rrefshes e rrëzë shpatit shkëmbor ishte dhe është një burim i madh uji. Ishte një vend e një pyll shumë i mirë për kullotje e bagëtive e sidomos për kullotje e dhive. Dhe, një ditë vere, një bari që po kulloste dhitë aty, po pushonte pranë burimit të ujit dhe kur u ngrit dhe u largua, harroi aty kizën (këmesë e vogël). Dhe, kur në mbrëmje u kthye me tufën e dhive në shtëpi, familjarët e pyetën se nga e kishte kullotur tufën e dhive, ai u tregon drejtimin nga i kishte kullotur dhitë dhe u thotë e u tregon se atje, tek burimi sipër pyllit me lajthi e rrëzë shpatit shkëmbor, kishte pushuar dhe atje kishte harruar edhe këmesën e vogël, kizën. Edhe të nesërmen, bariu, tufën e dhive e kishte çuar dhe e kishte kullotur përsëri aty, ku e kishte kullotur edhe një ditë më parë. Kishte shkuar tek burimi dhe aty kishte gjetur edhe kizën, që e kishte harruar një ditë më parë. Dhe, kur në mbrëmje kthehet me tufën e dhive në shtëpi dhe familjarët e pyesin se nga i kishte kullotur dhitë, ai u përgjigjet shkurt: -Te lash krizën. Dhe që nga ajo kohë, shumë shekujt më parë, burimi i ujit dhe vendi morën emrin "Lashkizë", (lash + kizën) lashkizën).

Më vonë vendi u populua dhe u krijua fshati Lashkizë.

Mbi truallin e gurtë të Lashkizës malore, në krye të qendrës së Lashkizës dhe pranë burimit të madh të ujit, rreth dy shekuj më parë u hodhën themelet, ngriti muret dhe u lartësia e hodhi shtat kulla e madhe trekatëshe e Xheladin Hysës. Ishte kullë e madhe me tre kate, rrethuar me avlli të lartë dhe me portë të madhe avllie sa mund të hynte e të dilte kali apo mushka me ngarkesë. Shumë vite pas ndërtimit të saj, disa dekada më parë, për nevojat e familjes, kulla u modifikuar pjesërisht. Kati i tretë i kullës u hoq dhe kulla u zgjeruar në anën anësore. Por, sidoqë kulla u modifikuar, përsëri kulla është aty, në atë vend, në atë truall, mbi ato themele. Kulla vazhdon të jetë si më parë, e fortë, e qëndrueshme, e përdorshme, e banueshme. Ka ndryshuar pjesërisht vetëm forma dhe pamja e kullës, por nuk ka ndryshuar emri, tradita, bujaria dhe mikëpritja e kullës së parë, të vjetër e të madhe, kullës së Xheladin Hysës në Lashkizë.

Kulla e Xheladin Hysës në Lashkizë ishte dhe është dëshmitare e historisë shekullore, historisë së rreth dy shekujve, jo vetëm të Lashkizës dhe Dardhës, por edhe më gjerë. Bile, kjo kullë nuk është vetëm dëshmitare e historisë, por është edhe pjesë e historisë. Kjo kullë ka qëndruar në ballë të historisë, të luftës dhe të ngjarjeve të tjera të kohës, jo vetëm duke strehuar patriot e luftëtar të shquar, por duke pritur plumba e flakën e zjarrit të barbarëve sllavë, të pushtuesve serbë, të cilët dy herë i vunë zjarrin kullës, por kullën nuk e dogjën, kulla qëndroi e qëndron e fortë, si shkëmbi i Shkaurranit, sipër kullës e pranë kullës.

Kulla e madhe e Xheladin Hysës është trashëguar nga disa breza dhe tani përdoret nga nipat e stërnipat e Xheladin Hysës.

Kjo kullë kishte e ka emër jo vetëm në Lashkizë e në Dardhë. Por edhe në zonat e tjera. Ajo kishte emër e zë, jo vetëm për lartësinë dhe madhësinë e saj, por për besën, mikpritjen dhe bujarinë. Dera e kullës ishte e hapur dhe sofra ishte e shtruar për dashamirës, miq e udhëtarë. Në atë kullë kishin ardhur e në sofrën e asaj kulle ishin ulur shumë burra me shumë zë dhe emër, prijësa të luftës e patriot të shquar të çeshtjes sonë kombëtare, si Elez Isufi e Suf Xhelili dhe miq të familjes si Mena i Lurës, etj. Bujaria shtronte dhe mbushte sofrën e Xheladin Hysës e besa ruante kullën, sofrën dhe miqtë. Varfëria fshihej, varfëria nuk fliste, sepse në këtë kullë fliste e këndonte besa, bujaria dhe mikpritja.

* * *

Që nga koha kur u ndërtua kjo kullë, gati dy shekuj më parë, vitet dhe koha kanë ecur. Kanë ndryshuar brezat, ka ndryshuar dhe kulla, por nuk kanë ndryshuar themelet e saj. Kanë ndryshuar njerëzit, pasardhësit dhe trashëgimtarët e kullës, kanë ndryshuar edhe miqtë e saj, por nuk ka ndryshuar tradita, bujaria dhe mikpritja e kullës së Xheladin Hysës. Sigurisht, bujaria dhe mikpritja ka edhe shumë kosto, jo vetëm ekonomike. Në kullën dhe për kullën e Xheladin Hysës, sofra, bujaria dhe mikpritja e kësaj kulle, pati jo vetëm kosto ekonomike. Por më shumë se kosto ekonomike, pati kosto politike.

Pas vendosjes së sistemit komunist në Shqipëri, pushteti dhe diktatura komuniste në Shqipëri, ndërtoi dhe përdori një strategji të egër për të dobësuar familjet dhe miqësitë e familjeve me reputacion, me peshë, me zë dhe me emër, në të gjithë vendin, por veçanërisht në veri, ku kjo strategji e egër u shoqërua me dhunë të egër, me dënime, internime e pushkatime. Dhe, pas ndëshkimit të rëndë ndaj familjes së madhe të pasardhësve të Elez Isufit e Suf Xhelilit, të familjes së madhe të Cen Elezit, si dhe dënimit dhe vrasjeve të shumë djemve e burrave të Menës në Lurë, radha i erdhi edhe Xheladin Hysës, se ishte miku i tyre dhe, sigurisht, i kishte prit e përcjell si miq. Se, kulla e Xheladin Hysës për miqtë kishte dhe jepte bukë e besë. Dhe pushteti e diktatura komuniste sajoi, montoi, ndërtoi e ngriti akuza absurde dhe Xheladini u burgos, u dënua dhe bëri disa vite burg. Por, me gjithë burgosjen dhe dënimit me disa vite burg të Xheladinit, kullën nuk e trembi as dënimi, as hija e persekutimit. Kulla nuk e ndryshoi traditën, nuk e zbehu e nuk e zvogëloi bujarinë dhe mikpritjen, nuk e mbylli derën dhe nuk e ndërroi e nuk e fshehu sofrën.

Por edhe miqtë e Xheladin Hysës nuk u trembën nga hija e persekutimit politik të kullës. Miqtë nuk e ndalën rrugën. Përsëri, në kullën e tij vazhdonin të vinin miq e dashamirës. Bile vinin edhe nëpunës e pushtetarë të kohës. Familja e Xheladin Hysës ishte familje e madhe, me shumë anëtarë, me rreth të madh miqësor, me shumë hyrje e dalje dhe ndonëse nuk kishte burime të mjaftueshme të ardhurash, çuditërisht, familja e tij, në çdo periudhë kohe kishte gjendje ekonomike të qëndrueshme dhe të stabilizuar.

* * *

Nga martesa e parë, Xheladin Hysa pati vetëm një djalë, Xhemaliun, i cili mbeti jetim, sepse nëna e tij vdiq në moshë shumë të re. Ndërsa nga martesa e dytë me Baftie Kacën nga fshati Tartaj, nuk patën fëmijë. Por, fatmirësisht, djali i tij, Xhemaliut u rrit, u martua me Bardhe Laçin nga Gjurrë-Reçi dhe patën shumë fëmijë, pesë djem e katër vajza, njëra nga të cilat vdiq në moshë të vogël. Dhe, Xheladini e Baftia nuk e ndjen mungesën e fëmijëve të tyre, sepse u bënë me shumë nipa e mbesa dhe shtëpinë e kishin plot, sytë plotë e zemrën plotë.

Edhe pse Baftia nuk lindi fëmijë, martesa me Baftie Kacën ishte fat për Xheladin dhe fat e mbarësi për familjen, shtëpinë dhe kullën e Xheladinit, sepse Baftie ishte një grua zonjë, një grua burrneshë, fisnike, e zonja, e gjallë dhe energjike, e zgjuar, e shkathët dhe e papërtuar, jo vetëm për punë, por dinte të drejtonte dhe administronte ekonominë familjare. Ishte grua e fortë dhe nismëtare, guximtare dhe krenare.

Edhe pse Baftia nuk lindi e nuk pati fëmijë, as ajo as Xheladini nuk e ndjen mungesën e dashurisë prindërore, sepse të gjithë nipat dhe mbesat e tyre, fëmijët e Xhemaliut e Bardhes, i deshtën dhe i respektuan gjithmonë, gjithë jetën. Të gjithë e deshtën si nënë dhe e thirrën "Nëna e madhe". E thirrën "Nëna e madhe", se ajo e meritonte këtë emër, se ajo i donte dhe kujdesej për ta tamam si nënë. Ajo ishte "nënë e madhe", se ishte si nënë, jo veç për nipat e mbesat, fëmijët e Xhemaliut e Bardhes, por për gjithë fëmijët e lagjes, fisit e fshatit të Lashkizës.

Baftie Kaca e ka merituar respektin e të gjithëve, prandaj, ajo dhe emri i saj kujtohen e do të kujtohen me shumë respekt e mirënjohje.

Na ndiqni:

RRUGA E ARBËRIT
https://www.facebook.com/gazeteerajonitteDibres

www.rrugaearberit.com

Bëj një abonim online ose në print...
Kushton vetëm 600 lekë në vit...
email: rrugaearberit@gmail.com

Dëshironi të **BOTONI PAK KOPJE LIBRI**,
por nuk mundeni sepse shtypshkronjat ju kërkojnë të paguani për një tirazh të madh...
Tani nuk është nevoja të prisni...
JU OFROJMË BOTIME NGA 1 KOPJE E VETME!
Njëlloj si në shtypshkronjë... Çmime të favorshme dhe shpejtësi!
Telefono: **068 65 08 441** ose shkruaj email: **mbbotime@gmail.com**

BOTIMET M&B
mbbotime@gmail.com
069 20 68 603 / 04 22 33 283
Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë librarisë sonë në Tiranë në rrugën "Isa Boletini", pranë kryqëzimit te Selvia ose mund t'i porosisni online.
Posta brenda vendit është FALAS

Fabula nga Mevlud Buci

PA FRE

E mbathën një kalë,
I vunë potkoj,
Ai sillej vërdallë
Pllajës harbonte.
E nisi revanin
Kodrave gjelbëruar,
S`e duronte samarin,
Kalë i harbuar.
Që atëherë e qëmoti
U përhap mbi dhe:
Dështak del i zoti
Me kalin pa fre.

MJEGULL

U mendua ujku te gardhi
Se ai pa shumë rregull,
Para se drita të zbardhi,
Sulmoi, veç kur ra në mjegull...

KAKARISJE

Sa ra nata, një pulë këndoi.
Ajo që sillej serbes-serbes,
Koha të vërtetën provoi:
Kjo nuk bën vezë në mëngjes.

TENDERIM

Ua dha pa mëdyshje juria e mavrisë,
Ua dha koncensionin horror të qeverisë,
E dhanë me votë, pa ngurrim,
Ujkut ia dhanë të bëjë tenderim.

GARË

E nis sulmin të bëhej i parë
Ujku plak që iu zunë shtigjet,
Në emër të ligjit bënte si i marrë
Bënte revan, se gjoja mbron ligjet.

SHUSHUNJË

E zgjodhën e ngritën e bënë deputet
E mirëpritën e respektuan shumë,
Ai vetëm dërdëlliste në parlament
Larg elektoratit, si shushunjë...

ANTIHUMANI

Një pacient, disa ditë me radhë
Vajti për t`u vizituar,
Dardha o njeri bie nën dardhë
Me biznesin janë shartuar.

POSTOMANI

E shkarkuan nga posti i drejtorit
Atë që kishte bërë plot dredhi,
Eprorët, geni i horrit të horrit
E bënë zëvendës-ministër në qeveri.

EKRAN

E nisën bisedën me dam-dume,
Të shquarit që bënin si arrat në thes,
Ata që koha i barazon me krunde
Karrieristë, llafollogë shpirtzes...

HESHTJE

Ajo trumbetoi luanit :ik, ik!,
Ajo brodhi shesheve në bulevard,
Mbeti me gisht në gojë, u fik,
Politikani gojëndyrë, bastard.
Një laraskë si motër qeshte.
Si vallë tellallja heshtte?..

FUND

Pinin lkrah për krah njëri-tjetrit
Bën revan posteve shtetërore,
Koha i nxori si lëkura e pjeprit
Të ngjiturit me stile dredhore.

Kur u dolën lakrat në shesh
I thanë njëri-tjetrit të palara,
Bota u çudit me ta duke qesh.
Mjerë kush na paska pri përpara!...

SINONIM

Në monizëm ishte propagandist,
Në neomonizëm patronazhist,
Një luznak që me batuta na shkriu
Tha :Ali Hoxha, Hoxhë Aliu...

PAUDHËSI

Bëjnë sikur zihen në parlament
Flasin me batuta, citate, gallata,
Gënjeshtarët, hipokrizinë kanë talent,
S`njohin veç lajka e shamata...

POST

Akuza, akuza e veç akuza
Përbaltje, grindje, stil harkor,
Thashethemet porsi tërkuza
Viva-viva posti shtetëror!

DËSHTIM

Bëjnë sikur grinden, dërdëllisin,
Ata që përbetohen, livadhisin,
Shqyhen për ata që i votëbesojnë
Paçka se elektoratin harrojnë.

TARTUFËRI

E ngjiti në aparatin ministror
Nusen e shokut të etur për pozitë
Pushtatari mjeshtëri si hamshor,
Dredharaku, kopuku i pa meritë..

PËSIM

E pësoi nga dlirësia,
E goditën lajkatarët dredhia,
Ishte i hapur, i sinqertë,
Por kot s`i thonë:
Pyet shtatë a tetë
Dhe bëj si të dish vetë.

MJERANI

Edhe titujt i lexon kalimthi
Me përbuzje shpërthen në zili,
I ngjitur posteve me lajka vetëtimthi
Kolltukofagu i lindur për dredhi.

KNFORMIZËM

Ajo hesht, kurrë nuk debaton,
Fjalët e drejtorit i quan hyjnore,
Veç thotë amin dhe penetron
Për drejtuesit bëhet therore.

THIRRJE

Urith e dhelpra, ujqër dhe çakej
Bredhin e bredhin si të mëdhenj,
Dërdëllisin me forcë pa merak
Sitë e kohës bëhu o SPAK!...

KAZANËT

Nisin bisedën në ekrane, në tavolinë,
S`lënë rend filozofë-babaxhanët,
Populli nënqesh me gjurulldinë
Prashisin në kep llafollogët, kazanët...

JANË POR(!)

Qysh vallë shtetari kot flet?
Zotimet e tij janë si shkarpa,
Boshët pa prova, boshët në pushtet
Janë si ata të plakut, por te vatra...

MASHTRIM

Erdhën në bazë delegatë me dyzina
U zotuan, folën e folën me eks, me bujë,
Gënjeshtarë, servilë e konkubina
Dolën fyl, bënë vrima në ujë...

EKSTREMIZËM

Ajo grindej, ndërhynte në fjalë si pykë
Pa leje, në parlament, kur tjetri fliste,
E specializuar me dy diloma në Amerikë
E përdala, karrieristja ekstremiste...

SHARLATANËT

Vallë, përse ngjiten duke e dredhur
Përse kërkojnë pushtet, pozitë,
Llafollogët, pordhilitikanë të rrjedhur,
Kryekopukë, pa hiç meritë.
Janë gen dredhie-vlla me shejtanët,
Votë-përdruesit, të pafytyrët, sharlatanët...

FLURACËT

Flasin për ligj e për drejtësi
Për demokraci flasin, për shtet,
Ata që demostrojnë veç hipokrizi
Tellallët që pëllasin në parlament.

DY GJELAT

Nuk fituan pushtet, ua vodhën,
Boshi kurdoherë bosh mbet,
nuk vendosi drejtësi e përdrodhën
I ngjan shtëpisë pa themel.
Qeshte plaku dhe gjyshe Suela
Gajasej dhe bota me dy gjela.

TREGIM NGA OSMAN XHILI

Pesha e gruas

Sabri Allamani po mendonte të fejojë e martojë, vajzën e fundit, Sabrijen. Kishte martuar pesë fëmijë deri atëherë, tre djem dhe dy vajza dhe kjo e fundit do të mbyllte ciklin e martesave . Një rezultat i barabartë, gjithsesi, tre nuse të marra dhe tre vajza të dhëna. Duke qenë dhe vetë mësues, kishte dashur ta shkollojë dhe më tej, por Sabria nuk kishte shkuar më shumë se shkolla e mesme. E kishte dashur shumë fëmijën e vogël, si bekim nga Zoti, ndaj kishte ngulmuar që dhe emrin ta kishte disi të ngjashëm e të afërt me të tijin. Shumë njerëz e fise të mira kishin ardhur për ti kërkuar dorën vajzës, por çuditërisht, tek fëmija i fundit, ai po stepej jo pak e nuk po vendoste akoma.

Por, një ditë teksa po mendonte për fëmijët dhe familjen, Sabriu u ndje disi në faj, se mos me hezitimin dhe refuzimet e tij, po i shkatërronte fatin vajzës. I dha udhë mendimit se duhej të bëhej disi më i vendosur në vendimmarrje. Kërkesën e parë serioze që do ti vinte në derë, do ta pranonte për mik. Një djalë nga fisi Delia, nga një fshat jo shumë larg e pati këtë fat. Ai u bë i fejuari e më pas burri i vajzës së Sabri Allamanit .

Në ato kohra, familja e djalit në një mënyrë a në një tjetër, sipas traditës, duhej tu paguante një shumë të hollash, miqve të palës tjetër. Nganjëherë, një nga burrat me qeleshe, e hiqte atë nga koka dhe e shtrinte drejt mikut, që ajo ti mbushej me para. Herë tjetër dikush nga pala e vajzës hidhte një shkrepse në drejtim të miqve. Kjo nënkuptonte, që pas numërimit të kokrrave në të, që zakonisht ishin pesëdhjetë, të konvertoheshin me po kaq kartmonedha mijëshe, që për kohën ishte një shumë e madhe. Kishte raste kur pala e vajzës thoshte se nuk jemi gati këtë vit për dasëm. Kjo do të thoshte se duhej një shumë parash e më pas arrihej dakortësia, pasi hidheshin në tavolinë datat e mundshme nga të dyja palët.

Sabri Allamani u konsultua me të shoqen dhe vendosën që të mos u kërkonin gjë miqve. Ata ishin në gjendje të mirë ekonomike. Nuk kishin pse ti rëndonin miqtë, kur vetë vajza e tyre do të ishte një nga personat që do ta paguante këtë dënim. Erdhi dhe dita, kur mes miqve do të përcaktohej viti dhe data e dasmës, që në gjuhën e popullit quhej “prerje e paçit”. Miqtë erdhën. Babai i djalit, daja dhe njëri nga djemtë. Nga të vajzës, ishte Sabriu, një xhaxha, dy vëllezërit dhe dy disa kushërinj të parë. U pinë kafet sipas zakonit dhe miqtë po prisnin se sa do të ishte shuma e kërkuar dhe si do të kërkohej ajo. Por nga ana e Sabriut as shkrepse nuk u hodh, as qeleshe për tu mbushur me para dhe asnjë kërkesë tjetër e këtij lloji. Meqë kishte ardhur koha për tu ngritur, vetë miqtë pyetën nëse ishte nevoja për ti ndihmuar me diçka.

-Jo, nuk është nevoja, të nderuar miq! - foli Sabriu. Ne duam vetëm respektin tuaj, siç do ta keni ju respektin tonë. Le të dalim pak jashtë traditës, duke krijuar një traditë akoma më të mirë.

Miqtë mbetën disi të habitur. Ngulmuan sërish për të lënë një shumë të vogël parash, por jo dhe ajo nuk u pranua. Nuk u mbetej gjë tjetër vetëm se të shtrëngonin duart, duke uruar për një miqësi të përjetshme.

Dasma e vajzës nuk kishte ndonjë emocion të veçantë, pasi Sabriu kishte bërë plot pesë të tilla. U ftuan plot miq e shokë, mish e pije me bollëk, urime për një miqësi sa më të gjatë, Sabria nuse

(Vijon në faqen 14)

cyan magenta yelloë black

TREGIM NGA OSMAN XHILI

Pesha e gruas

(Vijon nga faqen 13)

me vello të bardhë e fotografi të shumta bardhë e zi të asaj kohe.

Kishin kaluar tashmë dy muaj që nga ajo ditë. Njerëzit e burrit e donin, por nganjëherë nusja e re kishte dëgjuar dhe fjalë nënçmuese për të. Sa herë që ajo mund të bënte ndonjë gabim të vogël, vjehrra dhe dy kunatat lëshonin disa romuze si nën zë, por që gjithsesi vinin deri te veshët e Sabries. - Hë, se nuk e kemi blerë shtrenjtë nusen, aq e ka kapacitetin- Sa herë që thente ndonjë pjatë, apo nuk kishte fshirë oborrin si duhej, ato do të thoshin se nuk jemi shpenzuar shumë për të. Ndonjëherë tjetër ishin shprehur për të se qenka peshë e lehtë.

Këto fjalë e romuze e mërzitnin pa masë nusen e re. Vallë, ky ishte shpërblimi për gjestin fisnik të babait të saj, që nuk u kërkoi para, siç kishin bërë shumë të tjerë, në mos të gjithë? Ajo kishte lënë shtëpinë ku kishte lindur, prindërit dhe njerëzit e saj të afërm, për të ngritur këtu folenë e re. Do ti donte njerëzit e burrit, ashtu siç priste që dhe ata ta donin po njësoj. I qe ankuar të shoqit dy tre herë, po ai nuk kishte guxuar ta qortonte të ëmën.

Kur njerëzit e burrit e dërguan për të qëndruar një javë te shtëpia e prindërve, Sabriu e pyeti vajzën se si po kalonte te shtëpia e burrit. - Mirë o baba, ashtu do të mësohemi pak nga pak. Por kjo përgjigje sikur nuk e bindi Sabriun. I dukej vajza disi e mërzitur, disi pa oreks, disi e dobësuar. Ai kishte qenë mësues gjithë jetën dhe njihte mirë psikologjinë e nxënësve, jo më vajzën e tij. - Ti diç më fsheh, moj bijë? A dhe nga ne prindërit mban sekrete? Mos nuk të japin ushqim mjaftueshëm? Vajza qeshi lehtë, duke e siguruar që vërtetë ushqimi ishte i mjaftueshëm dhe për të mos e lodhur babain me hamendësime të tjera i tregoi shkakun e vërtetë.

-Tani po e kuptoj arsyen, foli Sabriu mendueshëm. Domethënë, respektin tim për të mos i gjobitur e tu merrja paratë para dasmës, ata ma paskan marrë për dobësi. Dakort, e rregullon babai këtë punë.

Java e qëndrimit të vajzës kaloi shumë shpejt, sikur të qe një ditë e vetme. Kishte ardhur dita për ta dërguar Sabrien te shtëpia e burrit të saj, por babai nuk po thoshte asgjë, a thua kishte harruar ditën. Kaluan dhe tre ditë të tjera. Sabria nuk po e kuptonte çfarë kishte vendosur babai dhe i vinte zor ta pyeste. Kur ishin mbushur plot dhjetë ditë në oborrin e shtëpisë së tyre u shfaq vjehrri, hypur mbi një kalë me shilten mbi samar. Sabriu e pa nga dritarja dhe doli në oborr për ta përshëndetur. U futën brenda, u rregulluan në shiltet e mbushura me lesh delje, u pyetën për shëndetin dhe për punën e ndërkohë u bënë kafetë gati.

O miku Sabri! – foli vjehrri i vajzës. A thua kam gabuar unë, apo ke gabuar ti?

-Përse o mik, ku e kishe fjalën?-bëri Sabriu, kinse nuk e kuptoi ku po e rrihte miku muhabetin.

-Po sikur e patëm lënë që ta sillje ti para tre ditësh nusen tonë në shtëpi. Ose, po tëna kishe thënë se ishe i pamundur, do të vinim ne ta merrnim.

- O mik i nderuar!- e mori fjalën Sabriu. As unë nuk kam gabuar dhe as ti. Tjetërkund është problemi. U krijua një heshtje për pak kohë, që prishej vetëm nga zhurma e shurdhër që bënte kafeja, kur e thithnin burrat nga filxhanat. Më pas dhe një tringëllimë e lehtë, kur ata uleshin në tabaka.

- Ju erdhët të më kërkonit vajzën para dasme dhe unë dola nga tradita, duke mos pranuar t'ju merrja paratë. Më dukej, se ashtu po e shisja vajzën dhe po fyeja miqësinë e re. Ju, këtë ma paski marrë për dobësi. I keni thënë vajzës se ti nuk vlen, se ti aq peshë ke dhe plot fjalë të tjera nënçmuese. Tani, mesa duket, paska ardhur koha, që unë të reflektoj e ta ndreq gabimin tim. Jo më pesëdhjetë, siç është zakoni, por njëqind mijë lekë dua të mi sillni, nëse doni ta merrni vajzën time për nuse. Në të kundërt, brenda javës do ta martoj tjetërkund.

Miku përballë mbeti për një moment i tronditur. Kishte dëgjuar disa muhabete grashë, por nuk u kishte dhënë shumë rëndësi. Tani ishte vënë para dy alternativash për të zgjedhur. Në ato kohra gruaja ndahej dhe ikte vetëm për moral, apo për vjedhje. U ngrit në këmbë dhe një nerv po lëvizte në faqe, ashtu i pabindur. Sabriu e luti të qëndronte për drekë, por miku i tha se kishte lënë disa punë për të bërë dhe doli te dera. Tha se do ta bisedonte me djemtë dhe do ti luante fjalë brenda dy tre ditëve.

Kur arriti vjehri te shtëpia, pa e pasur nusen me vete, të gjithë u habitën. Ata e kuptuan që kishte ndodhur diçka e rëndë dhe mendja u shkoi se mos nusja kishte qenë e sëmurë. Të vërtetën do ta mësonin nga goja e kryefamiljarit. U tregoi se ku qëndronte problemi dhe u tha djemve se duhej ti gjenin lekët që ishin kërkuar e të shkonin të merrnin nusen në shtëpi. -Shumë mirë na e bëri! I kishi thënë se është pa vlerë. Paguani tani dyfishin e vlerës!

Një pjesë të parave i kishin vetë, një pjesë i gjetën në shokë dhe miq. Në krye të dy ditëve vjehrri shkoi sërish te shtëpia e nuses. Piu kafenë si i zënë në faj, la paratë që i ishin kërkuar në tabaka dhe kërkoi leje të niset. Ndërkohë dhe Sabria ishte bërë gati për të shkuar me të. Kaluan disa javë nga kjo ngjarje. Te shtëpia e burrit askush nuk fliste më me nënçmim e romuze, por e trajtonin me shumë dashuri e respekt.

Një ditë Sabriu bëri një vizitë dhe hëngri drekë te shtëpia e miqve. Kur po bëhej gati për të dalë, la në tabaka njëqind mijë lekët që u kishte kërkuar para disa javësh. Paratë e kishin bërë efektin dhe nuk i duheshin më.

HOMAZH

Duriç, arti yt të bëri të pavdekshëm!



Kështu të njohëm e në vazhdimësi, Duriç të thirrëm. Me një energji dhe vullnet të madh, të pashtershëm. Vullneti, u bë arma kryesore në përballimin e jetës, ngritjen dhe realizimin e mbijetesës. Të gjithëve na duhet vullnet, por më shumë ty, miku im, aq shumë tu desh sa u bë e vetmja mënyrë e jetës tënde. –Jam në fillim, më thoshje, nuk më mjafton dita, të prodhoj duhet që blerësi të ketë mundësi të zgjedh. Të kujtohet si bëja shaka unë? Duriçi ka tre punë të varura në mur pa kornizë dhe blerësi gjithmonë në mos dy, një e merr. Punë titanike duhej për të mbushur muret e studios, tmerr sa shumë punë, pa orar e pa kohë. –Ti e ke shtëpinë, më kujtoje, unë jam me qera. Qera për shtëpinë, për studion qera, eh mik, një mal me lekë duheshin dhe vargmale me punë. Mund të pyes dikush. Kaq shumë tablo shiste Petriti sa murret e studios bosh i ngelnin? Kjo është një tjetër dhimbje. Me çimet e lira që Duriçi ishte i detyruar të shiste, normal që muret bosh ngeleshin.

Në këmbë, në hyrje të studios duke "pushuar" pak minuta, të mbaj mend dhe hopa mbi aromën e ngjyrave që çlirohej nga tavaloca jote. Vetëm ajo aromë kushedi sa shumë vite jete të ka shkurtuar. Ishin vitet e para të pas 90-tës, e cilësia e ngjyrave kineze që kishin hyrë në treg ishte shumë e rëndë por, ti duhej mbi to të vazhdoje punën, pa kohë.

E miku im, nuk e harroj atë shprehjen tënde: -"Jemi të dashmit e Zotit Zaim, po." –Po pse mo?- të ngucja. E thjeshtë, më shpjegoje, ne punojmë, pikturojmë dëshirat tona dhe vijnë të tjerët e na i blejnë.

Me penelin në dorë në kaq vite ti, nuk njohe argëtim e gëzim tjetër, vetëm punë, të rrisje fëmijët, ti shkolloje se, ty tu pre në mes ëndërra, shkolla e lartë e, më e bukura, nuk pate kohë as ta vuash atë, sepse të duhej të punoje shumë, shumë. E ku kishe kohë ti të vuaje ëndërrat e parealizuara? – Zaim, e vetmja ëndër imja është të mbërrij të kem një shtëpi timen, fëmijët të hapin derën e shtëpisë së tyre e jo dyert e botës. Ja dole mik, ja dole me penel. Kushedi sa km kanavacë ke pikturuar!

Një ndjesi ngjyre, që të veçonte dukshëm nga ne të tjerët, në vitet e shkollës, u detyrove ta flakësh, ta hedhësh tej, sepse e duan pastoze telajon blerësit, më thoshje. Një jetë punove për blerësit, o Zot, një jetë. As edhe një ditë të vetme për kënaqësinë tënde që shumë artistë kanë luksin të realizojnë. Një jetë zbukurove mjediset pafund të blerësve nga mos, në të gjithë Shqipërinë po e po, por tej kufijve, pa fund.

Bulqiza, vendlindja jote ngroh shpirtin me peizazhet e tua. Duhet të jetë krenare me veprën tënde.



Bulqiza, vendlindja jote ngroh shpirtin me peizazhet e tua. Duhet të jetë krenare me veprën tënde. E donin penelin tënd Duriç. Eh –nuk harroje të ma kujtoje, unë pikturoj për hall, jo për qef. Jo mik, jo! Shpirti jot është i shpërndarë si melhelm në qindra e qindra tablo. Të pikturuara për hall ishin por, të pikturuara me dashuri dhe përgjegjësi profesionale, deri në detaj. Peisazhe e portete, gjithçka i nevojitej blerësit, nuk i the kurrë jo.

Mik, unë e kam të vështirë ta pranoj që nuk mund të jemi bashkë për një kafe, që do të më mungojë pranija jote. Sa shumë nga miqtë e përbashkët më kanë telefonuar e përlotur përtej telefonit, atë ditë të ikjes tënde. Qanim dhe e largonim vdekjen, pa e besuar. Pa në këtë kohë, me një emër të frikshëm "Covid 19", kohëvdekja, më mirë thuaj, as edhe një grusht dhe nuk të hodha dot, plagë e kam.

U lumturova kur takova fëmijët. Prehu i qetë, thashë me vehte pasi, si drita i ke fëmijët mik. Në shtëpinë e blerë me artin tënd, djersën e dhimbjen tënde. Sa shumë na ke lënë për të të kujtuar Duriç, gjithë dhimbjen e gëzimin tënd të derdhura nëpër telajo, gjithë jetën tënde si një shembull vetmohimi, pune e respekti për jetën, miqtë e të gjithë.

Prehu i qetë në qiell mik, arti jot të bëri të pavdekshëm!

Zaim Elezi

Tiranë 12 Dhjetor 2021

Iljaz Haxhi Kaca ka punuar deri në frymën e fundit për Dibrën si truall e për dibranët e thjeshtë, studiues e intelektualë, prandaj tani dhe nesër ata do ta mbajnë të pashuar veprën e tij.

Gjurmuesi i zellshëm i vlerava arkeologjike ILJAZ KACA

Nga **SELMAN MËZIU**

Në trojet me relieve të sheshta, aty ku rrënjëzoi besimi katolik, me shumë institucione fetare, lindi Iljaz Kaca më 21.05.1933, mësues, historian dhe arkeolog. I zellshëm për të mësuar të fshehtat e së kaluarës, të fshatit të tij, dhe heroikës dibrane në honet e shekujve, e shtynë atë të jepte disa provime, për të mbaruar kështu me mund e djersë në vitin 1961 Institutin Pedagogjik, Gjuhë-Histori, dy vjeçar në Tiranë.

Edhe pse shërbeu prej më pak se dhjetë vjet si mësues matematike në disa shkolla të fshatrave të Dibrës, Iljazi nuk rreshti së gërmuari mbi historinë dibrane, duke grumbulluar të dhëna me dokumente, literaturë, intervista, duke pyetur luftëtarët e moshuar etj., si një bletë punëtore.

Mirëpo i pasionuari, gërmuesi në libra, doreshkrime e shkuar në vendngjarje historike duke mbledhur toponomastikën e relievet, Iljazi kuptoi se i mungonte edhe një provë tjetër materiale. Në këtë kohë ai kalon si mësues historie, së pari në fshatin Brezhdan. Në këtë kohë filloi të ndjekë disa kurse për arkeologji. Shkencë e rëndësishme në shërbim të shkrimeve historike, ku Dibra kishte shumë nevojë. Kjo disiplinë i shkonte për shtat pasionit të tij për ngulmimet e lashta deri në prehistorike të Dibrës. Këmbëngulja, vullneti, ndershmëria, saktësia në matje, mprehtësia në gjykime e shoqëronin në punën e tij, për të zbuluar gjithmonë e më shumë vendbanime qytezash, kalash në rrjedhat historike të popullit të lashtë penesto- dibran. Atje Iljazi, jo vetëm gërmonte, por kryente matjet e tyre, i sistemonte, i datonte dhe shkruante në organet e ndryshme ta shtypit. Ku numërohen më shumë se 110 artikuj të ndryshëm me zbulimet arkeologjike dhe temat historike.

Materialet e zbuluara, anë e kand Dibrës u bënë baza materiale për ngritjen e dhomës së arkeologjisë në muzeun e qytetit të Peshkopisë, qendra administrative e Dibrës së Poshtme, stendat e të cilit u risistemuan pas dyndjeve të dibranëve "për të fituar demokracinë", ku një pjesë u shkatërruan e të tjera dhe u vodhën. Ishte Iljazi së bashku me bashkëpunëtorin e tij të ngushtë historianin e shquar dibran, të ndjerin Moisi Murra, të cilët i sistemuan, i etiketuan përsëri në dhomën arkeologjike dhe gjitha muzeun e qytetit të Peshkopisë. Dëshmitar duke i shikuar, kam qenë edhe unë, kur më tregonin harbutërinë e disa të rinjve dibranë edhe ndaj objekteve vlerë shumta historike, të muzeut si materiale komuniste.

Pas një pune të shumëvullnetshme me studimet hartografike të vjetra e të reja, me grumbullimin e një literature të bollshme të huaj e të vendit, me gjetjen në arkiva të shuma të dokumenteve, historiani Iljaz Kaca del përpara lexuesve e studiuesve dibranë me librin e tij të parë ***"Rrugët e vjetra t*ë *Dibrës", Tiran*ë ***2003,*** ku në faqen e brendshme ai shkruan: *"Ia kushtoj babait tim të ndjerë, Haxhi Kaca, i cili më nguliti që në vegjëli dashurinë për historinë e vendlindjes, studimin e së cilës ai e kishte me pasion"*. Kjo lidhet edhe me faktin se vetë Iljazi ka mbjellë te fëmijët dashurinë për historinë, duke investuar për botimet, dhe njëri prej tyre më 19.08.2013 më shpjegoi: *''Të gjitha materialet e babait, kasetat me intervista, materialet dorëshkrim dhe shkrimet e tij unë do t'i sistemoj, i etiketoj dhe do t'i ruaj si relike të çmuara"*.

Falë durimit të tij, mendjes së tij kureshtare, përgatitjes së tij në fushën e historisë, arkeologu Iljaz ka marrë pjesë në disa ekspedita arkeologjike ne rrethet Korçë, Kukës, Mat etj., duke marrë pjesë e përgatitur disa kumtesa në sesionet e ndryshme shkencore në rrethin e Dibrës dhe jashtë saj. Ndihmesa e tij ka qenë e madhe në ngritjen e muzeve në shumë qendra fshatrash të Dibrës së Poshtme.





Adem Bunguri: ''Iljaz Kaca hyri në historikun e arkeologjisë së zonës së Dibrës që në fillimin e viteve '70 të shekullit të kaluar. Pasues i denjë i veprimtarisë arkeologjike të Mësuesit të Popullit Selim Alliut dhe studiuesit H. Sadikaj.

Fruti i punës së tij gjurmuese, këmbëngulja për të realizuar objektivat, qëllimet që i kishte vendosur vetes, Iljazi botoi librin e tij të dytë me karakter historik: ***''Isuf Karhasani,,, Tiranë 2006***, për të hedhur dritë mbi arkeologjinë dhe pasqyrimin e ngjarjeve historike dibrane, ai në fund të këtij libri ka vendosur 26 fotografi nga Gradeci, Shoshaj i Matit, Shpella e Radit, shtëpia E Dan Lekës e Bulaç të krahinës së Muhurit e deri në Gramë, Gjuras, Gurra e Mazhiocës, të shkrepura me aparatin fotografik bardha e zi të tij.

Pas më shumë se dyzet vjet ''marthonomaku arkeolog dibran,, Iljaz Kaca pasqyron punën e tij pasionante, të saktë, të një kërkuesi plot zell, të lexueshme në materialet arkeologjike në çdo pëllëmbë historie ngulmime dibranësh, në librin e tij të tretë: ***"Dibra në faqet e një ditari arkeologjik", Tiranë 2012.*** Ku ai shkruan ndër të tjera: *''... nuk mund të le pa falenderuar akademikun Kristo Frashëri, q*ë më dha shtysën e parë dhe më mbështeti fuqimisht, që të *merrem me arkeologjinë"*.

Ndërsa po paraqesim se si e vlerëson profesor Adem Bunguri kolegun e tij dibran Iljaz Kacën: *''Ai hyri në historikun e arkeologjisë së zonës së Dibrës që në fillimin e viteve '70 të shekullit të kaluar. Pasues i denjë i veprimtarisë arkeologjike të Mësuesit të Popullit Selim Alliut dhe studiuesit H. Sadikaj. Pasues i denjë i punës së tyre I. Kaca do të kthehej shpejt në një gjurmues të zellshëm të vlerave arkeologjike dhe veçanërisht të kulturave prehistorike të Dibrës.*

Fatkeqësisht sot më 27.12.2021 ka ndërruar jetë arkeologu historian, njeriu me shumë kulturë, i përkushtuari me mish e shpirt i arkeologjisë e historisë së Dibrës, ***Iliaz Kaca***.

Ai ka lënë prapa vlera të pallogaritshme për historinë dibrane që nga mugëtira e shekujve, kur njerëzit nuk shkruanin e deri në ditët tona. Iljazi ka lënë një arshivë shumë të pasur, të shkruara e materiale fotografike, dokumente dhe tre libra gati për botim si: ***''Trashëgimi ilire në trevën dibrane", ''Historia e fshatit Brezhdan" dhe "Gjip Pira"***.

Iljaz Haxhi Kaca, me rrënjë në Shorokan të krahinës së Muhurit, ka punuar deri në frymën e fundit për Dibrën si truall e për dibranët e thjeshtë, studiues e intelektualë, prandaj tani dhe nesër ato do ta mbajnë të pashuar veprën e tij, duke ndjekur shembullin e tij, shkëlqimplotë për historinë, arkeologjinë, etnografinë dhe kulturën, pasionin e punës së tij vullkan shpërthyes për t'u ndjekur nga brezat e sotëm e të ardhshëm.

Firence 27.12.2021

REKUIEM

Iljaz Kaca - mësuesi, studiuesi, arkeologu dhe qytetari i palodhur

Nga **HYSEN UKA**

Na la dhe Iljaz Kaca...! Na iku shoku, miku, mësuesi, arkeologu i pasionuar, studiuesi dhe autori i disa botimeve shumë të rëndësishme historike, jo vetëm për Dibrën, por edhe për historiografinë kombëtare.

Na iku një aktivist shoqëror, bashkëpunues e i palodhur, që ka lënë gjurmë të pashlyeshme në ngritjen e funksionimin e shoqërisë civile në Dibër. Mua më ka ikur njëri nga mbështetësit e bashkëpunëtorët më të përkushtuar, në atë që shpejt u bë nisma, qëllimi e objektivi mbarëpopullor, për gjithë Dibrën, realizimin e projektit jetik për rajonin, ndërtimin e Rrugës së Arbrit. Janë ditë, muaj, vite bashkëpunimi, të cilat kanë lënë gjurmë të thella në jetën time. Ka qenë një kohë kur ku gjendej njëri prej nesh, gjendej edhe tjetri, kohë kur falë pasionit dhe besimit në atë ide, ti sfidoje moshën...

Ndërsa i kujtoj ato vite, nuk mundem ta përmbaj e ta mposht lëmshin që më mblidhet në grykë, që më ligështon e më lag sytë..., ndjesi që provova edhe ditën e 29 nëntorit, kur më në fund, Rruga e



Arbrit u lëshua, nisi jetën e saj, e ëndrra jonë u bë realitet. Tek shikoja nga ura e hekurt, lart, drejt fshatit Shkallë, m'u kujtua 24 qershori 1998, kur ishim nisur në këmbë për në Xibër. Kishim ecur gjithë ditën... muzgu i mbrëmjes na zuri në Shkallë, para shtëpisë së Hasan Dalliut, i cili nuk na la të vazhdonim, por na dha konak. Ajo natë është nga netët e mia me të paharruara.

Unë i kujtoja këto, ndërsa Ti nuk ishe aty atë ditë të inaugurimit ...dhe po të mos kisha Bujarin në krah, unë do të ndjehesha krejt i vetëm, nuk kisha me kë t'i ngjallja kujtimet e mia. Bujari dhe unë kishim kujtime nga ajo kohë...

Ti nuk ishe Iljaz, ...pesha e moshës..., por as Hamiti, as Bajram Totraku, as Maliq Bitri, as Kalosh Tomçini, as...as... ishin shumë ata që mungonin, që nuk ishin aty të gëzonim atë ditë... Ti nuk ishe atë ditë aty, por dhe ishe... ishe në themel të këtij projekti epokal, ti i paharruari ynë Iljaz Kaca, bashkë edhe me shumë e shumë të tjerë, që keni vënë përpjekjet, kontributin në themel të kësaj vepre, ishit e do të jeni gjithmonë.

Për mikun dhe shokun tonë të shtrenjtë, nga ky mëngjes i zymtë dhjetori e në të ardhmen koha ka një kuptim tjetër, ka kuptimin e veprës së tij. Ti i shtrenjti ynë Iljaz na le veprën tënde, shembullin tënd, devocionin dhe përkushtimin tënd për të mirën shoqërore, ndaj do të mbetesh gjithmonë i paharruar.

U prehsh në paqe dhe u nderofsh përjetë!



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falënderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose përmes lidhjes:

https://tinyurl.com/lcc3e2f

Foto Majtas tregon pamjen e parë të faqes zyrtare në Facebook të gazetës *Rruga e Arbërit*

NE nuk jemi gazetë e pavarur, NE jemi gazetë e lirë
dhe pavarësia dhe liria jonë garantohet
vetëm nga mbështetja e lexuesve...

BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

TANI MUND TË PAJTOHENI PRANË SPORTELEVE TË POSTËS SHQIPTARE NË TË GJITHË SHQIPËRINË. NJË PAJTIM VJETOR KUSHTON 600 LEKË

BIGmarket

një epokë e re dashurie
ndaj jush po nis tani

GJITHMONË ME OFERTA...
PESHKOPI MAQELLARË